

Dr. Musli Vërbani

KËSHILLA FISNIKE

Kaçanik, 2019

Autori:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Këshilla fisnike

Korrektura:
Burim Bunjaku

Botues:
Autori

Shtypi:
“Fokus Print”, Shkup

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Kapitulli i parë

“trashëgimi” apo “ndarje”

Në popull janë të njohura termi “ndarje” dhe termi “trashëgimi”. Në esencë këto dy terme nuk e zëvendësojnë njëri-tjetrin edhe pse disa kur flasin për të parën aludojnë në të dytën dhe anasjelltas. Nëse mendohet se *ndarja* është *trashëgimi* është gabim, por edhe nëse mendohet se trashëgimia është ndarje prapë se prapë është gabim.

Termi **trashëgimi** vjen në kuptim konkret dhe në kuptim abstrakt.

Termi **trashëgimi** në kuptim abstrakt: **“Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve.”**

Termi **trashëgimi** në kuptim konkret: Trashëgimia e pasurisë.

Termi **ndarje** vjen në kuptim konkret dhe në kuptim abstrakt:

Termi **ndarje** në kuptim abstrakt: f.v. ndarja në kuptim të ideologjive, etj.

Termi **ndarje** në kuptim konkret: si f.v. ndarja e pjesëve të drurit, po ashtu ndarja e dy vëllezërve ku secili jeton ndaras njëri-tjetrit.

Në kuptim abstrakt mund të jetë ndarje edhe kur dy vëllezërit jetojnë në një shtëpi por që secili prej tyre jetën e vet në përfitim.

Kur fëmija i parë arrin moshën e pjekurisë fillon të punoj dhe fillon të pavarësohet, ai prej këtij momenti është i ndarë në kuptim abstrakt dhe ai duhet të punojë për veten e tij. Prej këtij momenti ai është i ndarë (dhe ende nuk është trashëgimtar) edhe pse jeton në një shtëpi me prindërit dhe vëllezërit. Ne e kemi shembullin e jetimëve të cilëve kur të arrijnë moshën e pjekurisë u jepet pasuria dhe prej asaj moshe ata mund të jetojnë me kujdestarin e tyre, por në kuptim abstrakt ata janë të ndarë. Në lidhje me jetimët, për kujdestarët e tyre Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“dhe jepuani pasurinë jetimëve kur të arrijnë moshën e pjekurisë.” (En-Nisa).** Pra, jetimëve kur të arrijnë moshën e pjekurisë u jepet pasuria dhe ata vazhdojnë ta menaxhojnë atë pasuri, fillojnë të punojnë dhe janë të ndarë nga kujdestari i cili është kujdesur për ta deri në atë moshë. Ndonëse ky ajet ka të bëjë me jetimët, po ashtu njëjtë ka të bëjë edhe me fëmijët të cilët rriten me prindër, pra për ata të cilët arrijnë moshën e pjekurisë. Në këtë rast fëmijët nuk kanë pasuri të trashëguar nga prindërit (se prindërit i kanë gjallë) dhe prindi e posedon atë pasuri, ndërsa fëmija duhet të fillojë të

punojë dhe të përkushtohet për të fituar pasuri dhe të siguroj jetën e tij, ndërsa prindi i dhuron pasuri, e përkrah materialisht, moralisht dhe fizikisht. Ata mund të jetojnë së bashku por në kuptim abstrakt ata janë të ndarë ndërsa në kuptim konkret ata vazhdojnë të jetojnë së bashku.

Kur djali i madh është i ndarë, atë që e fiton e fiton për vete. Ndihma reciproke nuk duhet të mungoj edhe në të ardhmen, ndërsa ndihmesa morale, materiale dhe fizike është një çështje tjetër, e cila ka të bëjë me aspektin e lidhjes farefisnore të ngushtë dhe ndihmë familjare dhe nuk ka të bëjë me fitim të pasurisë e cila duhet të ndahet një ditë në të ardhmen (pas 10, 20 apo 30 viteve).

Nëse pas ndarjes së fëmijës së madh ndodhë që prindi nuk ka pasuri të mjaftueshme dhe ka nevojë për ushqim, veshmbathje dhe vendstrehim, atëherë prindi ka të drejtë të merr nga fitimi i pasurisë së fëmijës së tij. Kjo argumentohet me thënien e Muhamedit a.s.: **“Ti dhe pasuria jote jeni të prindit tënd.”**

Mirëpo ne kemi raste kur fëmija i parë shkon në kurbet dhe atje punon tërë jetën dhe pasurinë të cilën e fiton e investon në ndërtim shtëpie, në blerje të pasurisë së patundshme, parcela të tokave dhe pas një kohe të gjatë kur të vjen deri te ndarja vjen deri te mosmarrëveshja, sepse *ndarjen* e quajnë *trashëgimi* por e vërteta është se në këtë rast nuk kemi as ndarje dhe as trashëgimi por përzierje të çështjes së fitimit të pasurisë, me fjalë tjera përzierje në mes ndarjes dhe trashëgimisë, me fjalë tjera ndarje të fitimit të përbashkët të pasurisë e jo trashëgimi të pasurisë.

Deri sa të jetë gjallë pronari (në këtë rast prindi), nuk ka trashëgimi. Ndërsa pas vdekjes së tij është trashëgimia të cilën e ka fituar ai vet, të cilën e ka trashëguar prej babës (gjyshit) ose që i është dhuruar ose çka u është lënë testament prej ndokujt. Pasurinë të cilën e fiton djali dhe e shton, qoftë nga kurbeti qoftë jo nga kurbeti, qoftë prej ndonjë dhurate ose prej ndonjë testamenti nuk bën pjesë në trashëgiminë e babait të tij kur ai vdes.

Bashkëjetesa për çfarëdo lloj arsye me vëllezërit dhe me nënën e babën është në rregull. Njeriu bashkëjeton, nën kërcënimin e fatkeqësive dhe momenteve të papritura. Mirëpo, familja dhe farefisi e ndihmojnë dhe solidarizohen me të. Islami i ka dhënë rëndësi ndihmës ndaj të afërmit dhe se çdo ndihmë ndaj të afërmit e bartë me vete shpërblimin e dyfishtë për dhënësin e saj, Muhamedi a.s. ka thënë: **“Lëmosha (ndihma) ndaj të varfrit**

është një sadaka, kurse ndaj farefisit është lëmoshë (sadaka) e dyfishtë, pra lëmoshë dhe ndihmë.”

Duhet të dimë se pas vdekjes së prindit, në pasurinë të cilën e ka fituar ai (e jo fëmijët e tjerë) bën pjesë edhe fëmija në barkun e nënës edhe fëmija i porsalindur dhe nuk ka të bëjë me atë se ai nuk ka fituar, me fjalë tjera nuk e ka shtuar pasurinë e prindit sepse pasuri e prindit është vetëm ajo pasuri të cilën e fiton vetëm prindi dhe jo të cilën e fiton njëri prej fëmijëve të tij dhe i bashkëngjitet atij. Në bashkëjetesë nëse veç ekziston duhet të funksionojë rregulli i sistemit të shoqërisë aksionare. Pra, në bazë të marrëveshjes të cilën duhet ta bëjnë vëllezërit e cila është e njohur si shoqëri aksionare apo që i ngjan shoqërisë aksionare që do të thotë që secili e merr pjesën e fitimit varësisht prej shumës së participimit, prej mënyrës së ndarjes së detyrave, obligimeve dhe në fund përfitimit, por duhet ditur se përfitimi duhet të jetë i njohur dhe i caktuar, siç është rasti me dhënie e paradhënie për prodhim industrial siç ka thënë Muhamedi a.s.: ***“Kush jep paradhënie për prodhim, le të jep në shumë të caktuar ose në sasi të caktuar për kohë të caktuar.”***

Është e vërtetë se fëmijët të gjithë nuk lindin në të njëjtën kohë. Është e vërtetë se të gjithë fëmijët nuk e kanë të njëjtën aftësi. Është e vërtetë se fëmijët nuk e kanë të njëjtin fat e kështu me radhë. Kështu ndarja nuk është e domosdoshme të ndodh në të njëjtën kohë për të gjithë fëmijët por ato mund të ndahen varësisht prej nevojave dhe dëshirave të tyre dhe në mënyrë graduale e që trashëgimia nuk është kështu, sepse trashëgimia ndodh vetëm pas vdekjes së babait ku edhe nëna merr hisen e vet ndërsa ndarja mund të bëhet edhe kur prindi është gjallë.

Për këtë arsye sa janë fëmijët e vegjël, nuk ndodh ndonjë konflikt. Konflikti fillon me rritjen e fëmijëve dhe ndarjen e pasurisë. ***“Ndarja e pasurisë (jo trashëgimia)”*** jo rrallëherë kthehet në një mollë sherri për shkak të pozicionimit të fëmijëve në pasuri. Praktikisht çdo gjë fillon mbrapsht pasi që asgjë nuk ka qenë e definuar më parë:

- Njëri thotë: Kam punuar në kurbet dhe nga fitimi im është shtuar kjo pasuri.

- Tjetri thotë: Unë kam qëndruar këtu dhe e kam mbajtur familjen, jam përkujdesur për nënë e babë.

- Një tjetër thotë: Por pasi që shkove ti në kurbet mua mu mbyllën dyert e kurbetit.

- Motrat mbajnë qëndrim neutral, ata nuk konsiderohen persona që kanë të drejtë në ndarje të pasurisë, ata nuk guxojnë të flasin, e mos të flasim që të kërkojnë diçka.

- Nëna nuk konsiderohet person i ndarjes por pasuri (leckë) trashëgimore, pra vetëm objekt e cila mund të i bashkëngjitet kujtdo. Në të shumtën e rasteve merr hise më shumë ai i cili do ta mban nënën në të ardhmen, thuaja se ajo nënë nuk është nënë për të tjerët në të ardhmen. Ndonjëherë ndodhë që ndonjë djalë e përzë nënën nga shtëpia, ndonjëherë asnjëri nuk e pranon me vete edhe nëse ajo me të cilin bie do të merrte më shumë pasuri se të tjerët, në të vërtetë ajo ka mbetur si mall, jo si person me të drejtë ndarje.

- Kësisoj në ndarje të pasurisë nis konflikti dhe cenohet marrëdhënia mes vëllezërve, nuk arrijnë mirëkuptimin me njëri-tjetrin dhe bëhet ndërprerja e lidhjeve farefisnore. Por duhet ditur se nëse ka qenë **obligim** në të kaluarën mbajtja e lidhjeve farefisnore, është **haram** në të ardhmen të bëhet ndërprerja e tyre. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“A pritet prej jush që nëse merrni sundimin të bëni trazira në tokë dhe të ndërpritni lidhjet farefisnore. Ata janë të cilët Allahu i ka mallkuar, i ka bërë të shurdhër dhe i ka verbuar.” (Muhamed : 22-23)**

Dhe në fund: T’i përmbahemi urdhrave të Allahut në tërësi, e jo të i përmbahemi në çështjet që na konvenojnë e t’i anashkalojmë në çështjet që nuk na konvenojnë.

Mirazi, haram apo farz

Fjala *miraz* në gjuhën e popullit kuptohet si diçka e zyrtë, e keqe dhe diçka për të cilën mallkohesh. Thuhet: “E ka ngrënë mirazin, për këtë arsye nuk ja ka pa hajrin.”

E, në të vërtetë, duhet të ishte e kundërta sepse kush nuk ja jep mirazin tjetrit nuk ja sheh hajrin, e jo ai (ajo) i cili e ka marrë *mirazin* sepse ata (ato) të cilët nuk e kanë dhënë mirazin e kanë ngrënë haram sepse mosdhënia e së drejtës së mirazit është haram. Zoti i Lartmadhëruar e ka quajtur mirathin farz, kurse dijetarët e quajnë *ilmul feraid*, me fjalë tjera, *shkenca strikte dhe e obligueshmërisë*.

Sa e sa motra nuk e kanë marrë dhe nuk e marrin mirazin!?

Sa e sa vajza nuk e kanë marrë dhe nuk e marrin mirazin!?

Sa e sa nëna nuk e kanë marrë dhe nuk e marrin mirazin!?

Kjo është rezultat i së drejtës zakonore shqiptare, ku gruaja nuk mund të jetë trashëgimtare as në shtëpinë e babait, as në shtëpinë e burrit.

Janë të panumërta vajzat dhe motrat të cilat nuk e kanë marrë mirazin (trashëgiminë) dhe nuk e marrin ende, sepse u thuhet se “nëse e merrni mirazin nuk e keni të drejtën e së *pames* në shtëpi të babës apo të vëllezërve”. Duhet të dimë se mirazi i tillë i cili njihet në popull buron nga jomuslimanët, qoftë prej ligjeve zakonore apo kanuneve joislame dhe termi “miraz” është përdorur si term përbuzës për shkak se vajzat konsiderohen të një rangu më të ulët se sa meshkujt, si shembull sjellim Kanunin e Lumës në të cilin thuhet: **“Trashëgimtarë të radhës së parë janë djemtë, e jo vajzat.”** Mirëpo, sipas këtij kanuni nëse i vdekuri nuk kishte djem, por vajza të martuara, vajzat thirreshin si trashëgimtare të radhës së dytë dhe konkurronin së bashku me kushërinjtë e tyre. Sipas këtij kanuni, pjesa e vajzave në pasurinë e të atit quhet miraz dhe përbëhej nga një e dyta, një e treta dhe një e pesta e tokës.

Kështu, te shqiptarët termi “miraz” përdoret vetëm në formë nënçmuese, pasi supozohet se vajza e martuar kërkon pjesë për t’ia bashkëngjitur burrit të saj.

Mosdhënia e mirazit vajzave është bërë zakon, dhe në rast se ajo e kërkon atë, vëllezërit i thonë atyre: “Nëse kërkon hi, nuk keni të pame në shtëpitë tona.” E veprimi i tillë u është ngulitur në kokë nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, në të cilin thuhet: **“Djemtë kanë hi, kurse vajzat nuk marrin hi për shkak se ato martohen dhe krijojnë familje diku tjetër. Vëllezërit i marrin në pushime. Ato kanë të drejtë dy herë në vit (për pushime) nga dy javë apo nga një muaj.”**

Mirazi i prindit për vajzë nuk i takon burrit të gruas por ajo e mban në pronësi të vet sikurse e mban mehrin. Gruaja disponon me pasurinë e saj te burri i saj në mënyrë të pavarur dhe sikurse i kryen në mënyrë të pavarur namazet dhe agjërimin ashtu në mënyrë të pavarur i kryen edhe obligimet materiale siç janë, zekati, haxhi, etj. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Besimtarët dhe besimtare janë dashamirë të njëri-tjetrit, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe e japin zekatin, respektojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij. Të tillët do t’i mëshirojë Allahu. Allahu është ngadhënjës, i Urtë.” (Et Tevbe : 71).**

Ajo çka ka ndikuar më së shumti që vajzat të mos e marrin mirazin ka qenë dëshira që dhëndëri të mos bëhet banorë në mes të miqve, mirëpo e kundërta ka qenë me Muhamedin a.s., sepse Muhamedi a.s. ka dashur që të blej një pronë afër shtëpisë së tij, me qëllim që vajza e tij Fatimja r.a. të afrohej më afër shtëpisë së tij me qëllim që ta vizitonte më shpesh dhe të vizitohej nga ajo.

Feja islame i ka dhënë të drejtë trashëgimie gruas, vajzës, nënës, gjyshes, vajzës së djalit, motrës, motrës nga nëna, motrës nga babai, etj., dhe i ka radhitur në radhët e trashëgimtarëve të domosdoshëm andaj shkenca e trashëgimisë quhet “shkenca e përcaktuesit dhe e farzit”.

Në islam, në shkencën e “përcaktuesit dhe farzit” (trashëgimisë) janë të paraparë tri peshoja.

Peshoja e parë është *shkalla e afërsisë*.

Dihet se çdo person, në këtë rast edhe nga femrat, ka shkallë të largësisë dhe të afërsisë.

- Sa më i afërt të jetë trashëgimtari, pjesa e trashëgimisë është më e madhe, pa marrë parasysh a është mashkull apo femër.

- Sa më i largët të jetë trashëgimtari, pjesa e trashëgimisë është më e vogël pa marrë parasysh a është mashkull apo femër.

Peshorja e dytë është *gjenerata e paraardhësve dhe pasardhësve*.

Njeriu është në mes të dy gjeneratave.

- Gjenerata e paraardhësve: baballarët/nënat dhe gjyshërit/gjyshet; dhe
- Gjenerata e pasardhësve: djemtë/vajzat dhe nipat/mbesat.

Gjenerata pas jetës së tij, djemtë dhe vajzat, nipat dhe mbesat, marrin pjesë më të madhe (sepse ata kanë nevojë më shumë për mjete materiale).

Gjenerata para jetës së tij, baballarët dhe nënat, gjyshërit dhe gjyshet, marrin pjesë më të vogël (sepse kanë nevojë më pak për mjete materiale kundrejt pasardhësve).

- Vajza si pasardhëse, trashëgon më shumë se nëna që është paraardhëse, ndërsa që të dyja janë femra dhe që të dyja janë të lidhura drejtpërsëdrejti me trashëgimlënësin;

- Vajza, si femër, trashëgon edhe më shumë se baba dhe gjyshi, të cilët janë pasardhës edhe pse të dy janë meshkuj.

Peshorja e tretë ka të bëjë me *përkujdesjen obligative të paraparë nga sheriatu islam.*

Islami e obligon mashkullin (burrin) që të përkujdeset për ushqimin, veshmbathjen dhe vendstrehimin e femrës (gruas). Për këtë arsye, për të mos u dëmtuar mashkulli, është paraparë që të marrë pjesë të dyfishtë kundrejt femrave. Ka raste kur femra trashëgon barazi me mashkullin, sikurse e kemi rastin kur baba dhe nëna trashëgojnë hise të barabarta kur i vdekuri lë pas vete fëmijë, qoftë mashkull, qoftë femër. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë: **“Kurse prindërve, çdonjërit prej tyre i takon një e gjashta që ka lënë (i vdekuri), nëse ka fëmijë.”** (Nisa : 12). Pra, edhe baba edhe nëna marrin pjesë të barabarta nëse i vdekuri lë fëmijë. Pra në këtë rast gjinia femërore trashëgon barazi me gjininë mashkullore.

Krejt në fund, le të dihet se fjala *miraz* e cila përdoret në popull është fjalë e cila e ka burimin prej fjalës arabe *mirath* që do të thotë *trashëgimi*, por në praktikë edhe sot e kësaj dite kjo trashëgimi (miraz) po gjen vështirësi në zbatimin e tij.

Vizita e varrezave dhe lutja për prindërit në ditën e Bajramit

Kohëve të fundit tek ne ka filluar të bëhet traditë që të bëhet homazh për të vdekurin me rastin e ditës së vdekjes, pastaj me rastin e përvjetorit të vdekjes, pastaj me rastin e ndonjë dite festive, etj. Fjala homazh nuk është fjalë shqipe, dhe do të thotë: ***Nderim i veçantë që i bëhet një njeriu ose kujtimit të tij në shenjë dashurie e mirënjohjeje të thellë.***

Kjo traditë, pra homazhi për të vdekurit, nuk ka të bëjë me ditën e Bajramit, por ka të bëjë me ditë tjera përpos ditës së Bajramit dhe nuk ka asgjë të përbashkët me islamin.

Në të kaluarën ka qenë edhe një traditë (joislame), në atë kohë pas namazit të bajramit, xhemati nuk kanë bërë bajram mes vete, por në rend të parë kanë shkuar te varrezat dhe kanë bërë bajram (siç kanë menduar ata) me të vdekurit, e tek pastaj kanë bërë bajram mes vete dhe kanë shkuar te familjet e tyre për të bërë bajram.

Te disa ka qenë edhe një tjetër traditë (*natyrisht se nuk është traditë islame*), xhemati e kanë falë bajramin dhe kanë bërë bajram në xhami mes vete por nuk kanë shkuar në shtëpi, por në rend të parë kanë shkuar te varrezat kanë bërë bajram me të vdekurit pastaj kanë shkuar në shtëpi dhe kanë bërë bajram me të familjes dhe të tjerët.

Në esencë, vizita e varrezave në islam është sunet, por vizita e varreve nuk ka kohë dhe ditë të caktuar, qoftë javore, qoftë mujore, qoftë vjetore, por nëse vizita që bëjnë njerëzit në varreza pas namazit të bajramit, bëhet për të kujtuar vdekjen dhe botën tjetër, nuk përbën ndonjë të keqe në mënyrë absolute, sepse të shkuarit në varreza i kujton njeriut botën tjetër, ndërsa nëse vizita pas namazit të bajramit, bëhet për të qenë i mërzhitur apo për t'u ngushëlluar ose për të rregulluar e sistemuar varrin, kjo është e papëlqyeshme.

Muhamedi a.s nuk ka parapa ditë të caktuar për vizitën e varreve por ka thënë: **“Ju kam pas ndaluar që të shkonit në varreza, ndërsa tani mund të shkoni, sepse vizita ju bën që të jeni të kujdesshëm ndaj kësaj bote dhe ju kujton botën tjetër.”**

Vizita në varreza dhe lutja për të vdekurin dhe vetëm lutja për të vdekurin pa e vizituar te varri

Ashtu siç vizitohet i vdekuri te varri dhe bëhet lutje për të, mund të bëhet lutje edhe pa shkuar te varri.

Nëse shkohet në varreza bëhet kjo lutje, e cila njihet edhe si lutja e hyrjes në varreza:

“Paqja e Allahut qoftë mbi ju o banorë besimtarë të këtij vendi. Edhe ne me urdhrin e Allahut, kur të vijë përcaktimi i Tij, inshaAllah me ju do të radhitemi.

Allahu na mëshiroftë neve dhe juve dhe ata që kanë ikur para nesh dhe ata që do të vijnë më pas.

Lusim Allahun për ne dhe për ju që të na ruajë nga çdo gjë.

O Allah! Mos na e ndalo shpërblimin e tyre dhe mos na sprovo pas tyre.”

Dhe pastaj bëhet lutje për të vdekurin.

Muslimani për muslimanin lutet edhe në Ramazan edhe në bajram edhe në haxh edhe në namaz.

Muslimani lutet edhe për muslimanin e gjallë edhe për muslimanin e vdekur. Prej të drejtave të vëllazërisë dhe shoqërisë është lutja për vëllanë musliman, të gjallë apo të vdekur. Muslimani lutet për muslimanin dhe për familjen e tij ashtu sikurse lutet edhe për vetveten, sepse lutja mund të jetë shkak që i vdekuri ose të mëshirohet ose t'i lehtësohet ndëshkimi ose edhe gradat e tij të lartësohen.

Lutja për të vdekurit e ka vlerën ashtu sikurse vlera e dhënies së dhuratave për të gjallët. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Kur muslimani lutet për vëllanë e tij, pa ditur gjë (ky i fundit), lutja pranohet. Përpos kësaj, tek koka e lutësit qëndron një melek i ngarkuar të thotë, pas çdo lutjeje të mirë për vëllanë musliman, ashtu qoftë(Amin), Allahu të dhëntë edhe ty të njëjtën gjë!”

Në suretul Hashr, Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

“Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: - O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, Ti je vërtet i Butë dhe Mëshirëplotë!” (Hashër : 10)

Prej lutjeve për të vdekurin është edhe lutja për prindin e vdekur, qoftë te varrezat, qoftë në shtëpi, qoftë në bajram, qoftë në ditë tjera pos ditës së bajramit sepse Muhamedi a.s ka thënë:

“Kur ndërron jetë biri i Ademit, ndërpritet puna e tij përveçse tri gjërave:

sadakaja rrjedhëse,

dituria prej së cilës përfitohet pas tij, dhe

fëmija i mirë i cili lutet për të.”

Lutja bëhet edhe në gjuhën shqipe, edhe në xhami, edhe në rrugë, edhe në shtëpi, ashtu sikurse dhe kujtimi për prindërit bëhet edhe në xhami, edhe në rrugë, edhe në shtëpi, andaj lutja për prindërit e vdekur bëhet edhe për bajram, si në xhami, në rrugë, por duhet ditur se dita e bajramit është ditë feste dhe nuk është ditë mërzie dhe pikëllimi dhe nuk duhet mërzhitur dhe as pikëlluar por duhet lutur dhe shpresuar në pranimin e lutjes. Të bëjmë këtë lutje për prindërit tanë për ditën e festës së Bajramit:

Kjo festë le të jetë xhennet për ty prindi im.

Sot e gjithmonë varri tu bëftë dritë.

Sot e gjithmonë varri qoftë begati dhe qetësi për ty.

Sot e gjithmonë lutja ime le të jetë për ty.

O Zot në këtë ditë të bekuar mëshiroje prindin tim.

Shpërbleje me të mirat Tua.

Vendose ne xhennetin e lart Firdeus.

O Zot mëshiroje prindin tim me të mirët.

Vendose ne xhennet me të zgjedhurit dhe të graduarit.

O Zot varrin e tij bëje bashqë prej bashqeve të xhennetit, dhe ndarjen tonë me të bëje bashkim në xhennet.

Rreth ditës së mësuesit

Më 14 – 22 nëntor 1908 është mbajtur Kongresi i Manastirit, apo me fjalë tjera Kongresi i Alfabetit, pra, për përcaktimin e alfabetit të gjuhës shqipe.

Dy dekada më parë, në mars të vitit 1887 në Korçë është hapur mësonjëtorja e parë shqipe. Logjikisht duhej të ishte e kundërta, sepse para se të mësohen fjalët duhet të mësohen shkronjat, por ja që ka ndodhur e kundërta, por parashtrohet pyetja, ajo shkollë e parë shqipe, a ka mësuar me shkronja të alfabetit shqip (latin) apo...? Nëse quhet shkolla e parë shqipe do të duhej që në të të mësohej me shkronja shqipe.

Përndryshe, dita e mësuesit, pra, Dita Botërore e Mësuesit është më 5 tetor, pasi që UNESCO, në vitin 1994 e ka përcaktuar 5 tetorin si Ditën Botërore të Mësuesit.

Në Paris, më 5 tetor 1966 miratohet edhe Statuti i Mësuesve. Po në këtë vit, sipas idesë dhe sugjerimit të UNESCO-së është hartuar edhe betimi solemn i mësuesit mbi bazën e betimit të Hipokratit.

Në historinë njerëzore, i pari i cili të folurit e ka shprehur dhe e ka paraqitur me shkronja është mësuesi – IDRISI. Mësuesi – IDRISI është ai i cili i ka mësuar njerëzit që me anë të shkrimit t'i paraqesin rregullat e fesë dhe të shkencës, në mënyrë që njerëzit të jetonin të lumtur, të punonin me sinqeritet, t'i ndihmonin njëri-tjetrit për të krijuar shoqëri të shëndoshë.

“Në libër (Kur'an) përkujtoje Idrisin (mësuesin). Vërtetë ai (Idrisi – mësuesi) ka qenë i sinqertë dhe peygamber. Ai (Allahu) e ka ngritur në një vend të lartë.” (Merjem : 56, 57)

Pra, Idrisi është i pari i cili ka shkruar, ka lexuar dhe i ka mësuar të tjerët për shkrim-leximin. Për këtë arsye e ka marrë emrin Idris – MËSUES.

Idrisi ka pasur dëshirë që të udhëtojë nëpër botë që të përhapë fenë dhe t'ua mësojë të tjerëve rregullat e fesë, bashkëpunimit dhe mënyrën e jetesës në baza morale të shëndosha dhe fetare, për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar për të ka thënë:

“Ai (Allahu) e ka ngritur në një vend të lartë.” (Merjem : 57)

Pejgamberët, e prej tyre edhe vula e pejgamberëve Muhamedi a.s. na kanë mësuar ta njohim Krijuesin, ndërsa shkencëtarët na i kanë zbuluar zbulimet shkencore për të vërtetuar thëniet e pejgamberëve për të njohur Krijuesin – Zotin.

Në fund...

Ai i cili e do mësuesin, e do edhe nënën edhe babën edhe vëllanë edhe motrën edhe familjen edhe shoqërinë edhe atdheun edhe njerëzimin edhe natyrën edhe kozmosin. Ai i cili i ka këto virtyte, atë e ngritë Zoti i Lartmadhëruar lartë ashtu siç ka thënë Zoti i Lartmadhëruar për Idrisin – Mësuesin:

“Ai (Allahu) e ka ngritur në një vend të lartë.”

“bibël” apo “libër”

Fjala “**ILM**” në gjuhën arabe do të thotë: mësim, dituri. Bërthama e kësaj fjale përbëhet nga tri bashkëtingëllore “a”, “l” dhe “m” që do të thotë: njohje, shenjë apo shenjë e cila të bën të njohësh dhe të kuptosh diçka. Thotë Zoti i Lartmadhëruar: “**Dhe i kuptoi Ademi shenjat me të cilat mësoi emrat e çdo sendi**”.

Pas Ademit a.s. prej pejgamberëve të parë është pejgamberi Idris. Idris është fjalë nga origjina e fjalës “**De**”-“**re**”-“**se**” që do të thotë “zhvilloi mësimin”. Pra, pasi që ta kuptosh shenjën dhe e emëron sendin, për të njohur më thellë duhet analizuar atëherë vjen deri te studimi profesional, pra jo vetëm deri te mësimi fillestarë (jashtësor) por te mësimi i brendshëm thelbësor.

Pasi që të kuptohet dhe të njihet diçka nevojitet të **shkruhet**. I pari i cili ka shkruar është **Idrisi a.s.**.

Ajo në të cilën shkruhet diçka, në letra dhe çfarëdo tjetër, në gjuhën arabe quhet **kitab**- letër, libër.

Të shkruarit në shumë letra quhet **libër**, e që në gjuhën angleze quhet “**book**” dhe nuk quhet “**bibël**”

Parashtrohet pyetja: Çka quajmë **bible**?

Fjala **bible** rrjedh nga greqishtja: “**η Βίβλος** (i Vivlos)” - libri, në shumës “**(τα) βιβλία** (ta Vivlia,)” – librat, dhe është emër që përdoret nga hebrenjtë dhe të krishterët për shkrimet e tyre fetare që janë krijuar në një hapësirë kohore prej 200 vjetësh para erës sonë deri në shekullin e dytë të erës sonë.

Kuptohet se bibla është përmbledhje e shumë librave, posaçërisht atyre fetare (dhe jo shkencore) e të krishterëve dhe hebrenjve përafërsisht brenda 3-4 shekujve.

Në Kur'an fjala “**Kitab**” ka kuptim të *librit*, pra libri i cili ka zbritur prej Zotit të Lartmadhëruar, por edhe të *Kur'anit*, ku në kuptim të përveçëm libri i zbritur nga Zoti quhet **Kur'an** ndërsa në kuptim të përgjithshëm edhe libri i zbritur nga Zoti por edhe librat tjerë quhen **kitab**. Thotë Zoti i Lartmadhëruar: “**Falënderimi i takon vetëm Allahut që ia zbriti robët të vet Librin dhe në të nuk (lejoi) të bëhet kurrfarë shtrembërimi**”.

Vendi ku sistemohen, vendosen dhe ruhen librat quhet **Mekteb**.

Po ashtu **mektes** quhet edhe *mësonjëtorja fillestare*, me fjalë tjera *shkolla* sepse në mësonjëtores fillestare mësohen edhe shkrim-leximi por edhe edukimi fillor.

Institucioni, objekti dhe vendi ku thellohet mësimi, me fjale tjera prej atij fillorë në atë të mesëm quhet **Medrese**.

Objekti ku përmbledhen të gjitha njohuritë dhe shkencat shoqërore, ekzakte dhe fetare quhet **Xhamia (universitet)**.

Edhe fjala **“shkollë”** rrjedh nga greqishtja (skoli) që në gjuhën shqipe do të thotë *largim nga puna*, pra me nënkuptimin se nëse kryen shkollë ti do largohesh nga puna fizike dhe do kesh një lloj pune më të lehtë. Fjala shkollë nuk ka për qëllim vetëm të mësimi por ka për qëllim edukimin, arsimin dhe mësimin.

Shkolla është institucion i dizajnuar që nxënësi të mësojë çështjet fillestare të jetës dhe jo për të arritur nivelin e mësuesit.

Edhe pse fjala **“shkollë”** rrjedh nga greqishtja ashtu siç fjala **“bible”** (vivlio) rrjedh nga greqishtja, objekti në të cilën mësohet quhet **shkollë**.

Përmbledhja e shumë letrave, broshurave që kanë të bëjnë me çështje tjera përpos librave fetare krishtere dhe hebreje nuk quhet bible por quhet **book** (Libri është pjesa ku shkruhet apo ilustron e cila përbëhet prej faqeve).

Vendi ku shiten librat quhet **Book shop** dhe nuk quhet **librari**.

Shihet qartë se çdo bible është book (libër) por çdo book (libër) nuk është bible.

Biblioteka (libraria) është renditje e librave në bazë të autorit, lëndës ose katalogimit qoftë i atij personi privat apo atij institucional apo shtetërorë ose vendi në të cilin ruhen librat.

Libraria është koleksion i librave, përpos librave përfshinë periodikun e librave, revistave, hartave, dokumenteve, etj..

Bibliotekat (Libraritë) e para (sistemimi i librave) janë bërë para mijëra vitesh në Mesopotami.

Edhe firaunët i kanë ruajtur librat e tyre. Llogaritet se biblioteka (libraria) më e vjetër e tyre është ajo e firaunit Remzisit të madh.

Me kalimin e kohës fjala bibliotekë (bible) dhe fjala librari (libri) janë bërë sinonime të njëra-tjetres, përderisa gjeneza dhe burimi i bibliotekës ka qenë posaçërisht përmbledhja, kategorizimi dhe renditja e librave sipas autorëve, posaçërisht për biblën dhe jo për librat tjerë shkencorë, pra fjala bible është posaçërisht për librin fetar të krishterë që ka kuptimin e librit, kjo është arsyeja se edhe pse në gjuhën greke dhe

latine libraria prezantohet me emrin e bibliotekës ndërsa në gjuhën moderne tentohet që më shumë të prezantohet si librari se sa si Bibliotekë.

Ky është edhe shkaku se pse asnjëherë nuk dëgjojmë se dikush të ketë thënë: “shkova në librari dhe lexova bible”. Por: “shkova në librari dhe lexova libra”. Kemi dëgjuar: “shkova në bibliotekë dhe lexova libra” dhe nuk kemi dëgjuar: “shkova në bibliotekë dhe lexova bibla”.

“shkollë” apo “mësonjëtorë”

Fjala **shkollë** rrjedhë nga greqishtja *skoli* - σχολή. Pra, në etimologji, kjo fjalë nuk ka asgjë të përbashkët me gjuhën shqipe.

Fjala **alfabet** rrjedh prej kombinimit të dy shkronjave greke, α = alpha (lexo: Alfa) dhe β = Beta, pra edhe kjo fjalë është me prejardhje greke dhe nuk ka asgjë të përbashkët me gjuhën shqipe.

Arsimi është tërësia e njohurive dhe e shprehive që jepen me sistem e sipas një programi në mësonjëtorë e kurse të ndryshme për të mësuar e për të edukuar brezin e ri dhe masat e gjera punonjëse.

Historia e arsimit tonë është histori më vete. Shkrimi i gjuhës shqipe ka kaluar nëpër shumë faza deri në ditët e sotme. Në fillim, gjuha është mësuar vetëm gojarisht, e pastaj edhe me të shkruar, kështu duke u përdorur ndonjëherë shkronjat latine e ndonjëherë edhe shkronjat greke, shkronjat latine janë përdorur nga shkrimtarët arbëreshë kurse shkronjat greke janë përdorur nga kisha ortodokse.

Feja islame, që njihet si fe e diturisë, e zhvilloi shkrimin e shqipes me shkronja arabe. Feja islame pati një ndikim të madh në çdo popull me të cilin kontaktoi, e kështu ndodhi edhe me shqiptarët, andaj shohim se si letërsia e bejtexhinjve përbëhet nga poezi të shkruara me shkronja arabe. Intelektualët shqiptarë muslimanë veprat letrare në gjuhën shqipe i shkruan duke e përdorur shkrimin arab dhe ky lloj shkrimi gjeti shtrirje në të gjithë trevat shqiptare.

Me propozim të Sami Frashërit, ka filluar të bëhet shndërrimi i shkrimit arab në shkronja joarabe, duke u mbështetur në shkronja latine e duke e plotësuar me disa shkronja greke dhe me shkronja të tjera të veçanta, e ky lloj alfabeti është i njohur si “Alfabeti i Stambollit” e cila ishte edhe bazë për alfabetin e ardhshëm në Manastir.

Sot, rreth historisë së zhvillimit të mësonjëtorëve shqipe merren për bazë shkollat laike dhe nuk merren për bazë shkollat fetare, e në këtë rast mësonjëtorët islame, të cilat kanë qenë të shpërndara anë e kënd trojeve shqiptare, por narrativi i sotëm e merr si pikënisje mësonjëtorën e Korçës, të cilën e pason shkolla e Prizrenit.

Mësonjëtorja e Korçës është mësonjëtorja dhe jo shkolla e parë, e kjo mësonjëtorë është e vitit 1887. Kësaj mësonjëtorë nuk i ka parapri *Kongresi i alfabetit të Manastirit* i cili nga ana kronologjike u mbajt më vonë, si dhe parashtrohet pyetja se a është mësuar në këtë mësonjëtorë me alfabetin e manastirit i cili më vonë do të jetë alfabeti kryesor?. Në këtë mësonjëtorë

lëndët që mësoheshin ishin: shkrim dhe këndim, gramatika e gjuhës shqipe, historia, gjeografia, aritmetika, mësim natyre, etj.

Shkolla shqipe me shkronja arabe (islame) ka pasur edhe para kësaj kohe, e këto janë quajtur *mektebe* dhe *medrese*. Në medrese është mësuar: shkrim dhe këndim, gramatika, historia, gjeografia, aritmetika, shkencat natyrore si, matematika, fizika, etj.

Sot Manastiri nuk ka asnjë shkollë shqipe ndërsa është baza dhe qyteti i alfabetit.

Në botë sot njihen dy lloje të shkollave:

Mësonjëtorët (shkollat) fetare; dhe

Mësonjëtorët (shkollat) laike.

Në islam, kemi mësonjëtorë fetaro-shkencorë, dhe nuk ekzistojnë vetëm mësonjëtorë (shkolla) fetare edhe nëse sistemi arsimor është i natyrës fetare, sepse nuk ndahet feja nga shkenca, sepse në fe mësohet edhe për këtë botë edhe për botën tjetër, dhe ky lloj mësimi është obligim islam.

Pas luftës së dytë botërore, Kosova mbeti nën kthetrat e sistemit komunist. Pas kësaj, mësonjëtorët (mektebet) të cilat kanë shpjeguar mësim fetar janë shndërruar në shkolla, ndërsa hoxhallarët (mësuesit e mektebeve) kaluan prej mësimit fetarë në mësim të kësaj bote.

Sistemi komunist kishte dy qëllime: Dëshironte që mektebet e xhamive t'i shndërronte në shkolla laike dhe këtë synonte ta bënte duke i uzurpuar ato dhe duke deklaruar se këto janë prona publike dhe qëllimi kryesor ishte që në këto objekte të mësohej vetëm për këtë botë.

Feja islame është e kundërta e sistemit komunist. Në mësonjëtorë islame mësohet edhe për këtë botë edhe për botën tjetër.

Sistemi komunist dëshironte që mësuesit të ligjëronin vetëm materializmin apo ligjet e kësaj bote, kurse hoxhallarët janë edhe për ligjet e kësaj bote por edhe për ligjet e ndodhitë e botës tjetër.

Në esencë fjala *shkollë* që në gjuhën greke shqiptohet *shkoli* ka të bëjë vetëm me mësimin që të largon nga punët e rënda, e jo më shumë.

Parashtrohet pyetja: A duhet ta quajmë mësonjëtorën shkollë apo mësonjëtorë? A ta quajmë alfabetin abecedë apo abecedën alfabet. Kjo çështje duhet shikuar me kujdes, pasi këto çështje nuk janë sekondare, por janë çështje thelbësore të arsimit dhe këto e identifikojnë dhe e mbrojnë çështjen kombëtare.

Haraxhi, taksë apo...

Haraxhi (në shqip: haraçi) në kuptim të ngushtë është *taksë e tokës së punuar bujqësore*, ndërsa në kuptim të gjerë është *çdo lloj takse*.

Në islam kemi dy lloje të fondeve:

1. Fondi i zekatit; dhe

2. Fondi i tatimit.

Edhe fondi i zekatit edhe fondi i tatimeve janë burim i buxhetit.

Nuk lejohet që fondi i tatimeve të paralelizohet me fondin e zekatit nga shkakut se:

Fondi i zekatit është i destinuar për kategoritë e caktuara, si, të varfrit, të uriturit dhe nevojtarët.

Fondi i tatimeve është i përcaktuar si kundërvlerë e shërbimeve ndaj qytetarëve në përgjithësi, pra, edhe për të pasurit edhe për të varfrit, sepse, shembull, rrugët të cilat i shfrytëzojnë automjetet, ndërtohen nga tatimet për rrugë, mirëpo rrugët mund t'i shfrytëzojnë edhe të pasurit edhe të varfrit. Pra, shërbimet publike që përfitohen nga tatimet e shërbimeve publike janë në shërbim edhe të të pasurve e edhe të të varfërve. Tatimet kanë si synim investimet në projektet e nevojshme dhe të domosdoshme për interes të përgjithshëm.

Kemi dy lloje të tatimeve:

- Tatime të muslimanëve dhe dhënie të zekatit;
- Tatime të jomuslimanëve dhe mosdhënie të zekatit.

Muslimanët e kanë për obligim zekatin, ndërsa jomuslimanët nuk e kanë për obligim zekatin.

Përderisa muslimani e jep zekatin për kultivimin e tokës, atëherë jomuslimani e paguan tatimin e "haraxhit" për kultivimin e tokës. Nëse pabesimtari e blen tokën e dhjetëpërqindëshit të zekatit prej muslimanit, ajo tokë automatikisht shndërrohet në tokë të haraxhit, sepse jomuslimani prej asaj toke nuk e paguan dhjetë përqindëshin e zekatit. Kjo nga shkakut se toka është e përdorur për kultivimin e agrikulturës, e cila ka prodhuar, i është nënshtruar rregullit të tokës e cila ka paguar zekatin e një të dhjetës nëse ka arritur të prodhojë një sasi të caktuar të produkteve.

Tatimi i haraxhit është model për sistemin tatimor sepse prej haraxhit dhe tatimeve tjera investohen projekte të zhvillimit për: ndërtimin e urave, tendave të ujit për sistemin e ujitjes, etj. Kjo bën që fermerët të kuptojnë se çdo pagesë që ata e bëjnë në formë taksash u kthehet prapë në një formë

tjetër dhe është si një stimulim për të sjellë më shumë tokë për kultivim dhe rritje të prodhimit.

Për institucionin e tatimeve kanë shkruar dijetarët që nga fillimi i islamit e prej tyre nxënësi i Ebu Hanifes, Ebu Jusufi, i cili ka shkruar librin “Libri i tatimeve” (Kitabul harxh). Në këtë libër Ebu Jusufi ka sqaruar:

- Mënyrën e grumbullimit të tatimeve;
- Implementimin e tatimeve;
- Idetë rreth taksave dhe investimin e projekteve prej tyre;
- Shndërrimi i taksave fikse në ato jo fikse, etj.

Zekati është institucion qeveritarë ku qeveria organizon mbledhjen dhe shpërndarjen e saj, po ashtu edhe haraxhi është institucion qeveritarë ku qeveria bën organizimin e mbledhjes dhe të investimit të fondit të haraxhit për nevojat e agrikulturës dhe nevojave tjera të domosdoshme.

Dallimi i zekatit dhe haraxhit qëndron në atë se zekati është edhe donacion edhe ibadet (adhurim ndaj Zotit) ndërsa tatimi është detyrë në mes të palëve ashtu që njëra palë paguan palën tjetër të shërbejë për çështje të caktuara.

Kur’ani në mënyrë shumë precize e sqaron se ku duhet të shpenzohet zekati:

“Zekati është i destinuar vetëm për:

- **të varfrit (fukaratë) nga mesi i muslimanëve,**
- **të varfrit nga të huajt që banojnë aty (mesakin),**
- **për punonjësit të cilët i mbledhin taksat,**
- **për t’i përfutur zemrat e tyre (jomuslimanëve),**
- **për lirimin e robërve dhe të burgosurit e luftës,**
- **për t’u ndihmuar të zhyturve në borxhe,**
- **për në rrugë të Allahut, dhe**
- **atij që ka mbetur në rrugë,**

ky është një obligim nga Zoti dhe Zoti është i Gjithëdijshtëm, i Urtë.”

Në rrugë të Allahut – është fjali shumëdimensionale, në të cilën përfshihen prej dhënies për ushtrinë e vendit deri te dhënia e granteve në ndihmë të studentëve.

Zekati dhe taksat tjera të muslimanëve ashtu sikurse edhe haraxhi janë burime të buxhetit të qeverisë.

Haraxhi si taksë ka të bëjë me shtimin e prodhimit sikurse është zekati për shtimin e pasurisë.

Haraxhi, e cila llogaritet taksë e tokës, e cila është e ngjashme me zekatin, me përjashtim se nuk llogaritet ibadet sikurse zekati dhe caktohet që toka të mbetet në pronësi të pronarit të saj dhe të jetë e siguruar prej shtetit. Me një fjalë, haraxhi si taksë jepet për shkak se pronari i asaj toke merr pjesë në mbrojtje të drejtpërdrejtë nga ana e shtetit, e që gjatë asaj kohe pronari angazhohet me punimin e tokës.

Haraxhi është taksë për interesin e përgjithshëm dhe është vetëm donacion (tatim), e nuk ka kuptim adhurimi. Dihet se me mbledhjen e tatimeve dhe të zekatit rritet buxheti i shtetit nga ku investohen projektet e domosdoshme dhe të nevojshme të interesit të përgjithshëm, si: investimi në ushtri, në forcim të kufijve, ndërtim të infrastrukturës së qyteteve, si, rrugët, urat dhe objektet shtetërore.

Duhet ditur se projektet që janë shërbim të të gjithëve nuk jepet zekati asnjëherë, por zekati është institucion social për të varfrit, mirëpo kur plotësohen të gjitha nevojat e të varfërve, atëherë nga ai fond lejohet të investohet për nevoja të tjera shoqërore. P.sh. kur shteti nuk ia del ta realizojë buxhetin dhe nuk mund të ndërtojë shkolla nga fondi i tatimeve, në këtë rast zekati mund të destinohet për ndërtimin e shkollave. Për realizimin e projekteve shteti parasheh tatime në bazë të mundësive materiale të shtetasve. Kjo na bën të kuptojmë se ligji islam mbi financat ka një elasticitet të madh, dhe ky ligj i përgjigjet nevojave të çdo kohe, çdo vendi dhe çdo shoqërie.

Në fund, duhet ditur se haraxhi nuk rrjedh nga Kur'ani e as nga suneti, por është i aprovuar nga institucioni i ixhmait, nga dijetarët dhe nga tradita islame.

“zekat” apo “sadaka”

Populli është solidar, humanitar dhe ndihmëtar. Gjithmonë ka qenë e theksuar kjo ndihmë dhe ky solidaritet, e sidomos para luftës (në Kosovë, 1999), gjatë luftës dhe pas luftës. Kjo ndihmë dhe ky solidaritet është prezent edhe në ditët e sotit.

Dy institucione në islam siç janë zekati dhe sadakaja janë institucione të rëndësishme për shoqërinë. Ajo çka duhet të dimë është se çka është zekat dhe çka është sadaka dhe a është sadakaja zekat dhe zekati sadaka dhe pse nuk përqendrohemi në zekatin dhe pastaj në sadakanë, por çuditërisht jemi shumë sadakadhënës dhe nuk jemi aq zekatdhënës. Kjo, për shkak të mosdijes apo ka diçka tjetër?. Këtë dëshirojmë ta sqarojmë në vijim.

Çka është **zekati** dhe çka është **sadakaja**?

Fjala **zekat** gjuhësisht do të thotë: rritje, pastrim, etj..

Fjala **sadaka** rrjedh prej fjalës *sdk* dhe do të thotë: sinqeritet.

Termi **sadaka** nënkupton: dhënie vullnetare, kontribut vullnetar apo ndihmë vullnetare.

Zekati është farz, kush nuk e jep është mëkatar i madh.

Sadakaja nuk është farz dhe kush nuk e jep nuk është mëkatar.

Zekati është i përcaktuar në përqindje.

Sadakaja nuk është e përcaktuar në përqindje.

Edhe pse çdo **zekat** është edhe **sadaka**, çdo **sadaka** nuk është **zekat**, ashtu sikurse çdo **namaz** është **lutje** e çdo **lutje** nuk është **namaz**, sepse namazi i ka kushtet e saj dhe nëse i mungon vetëm një kusht atëherë nuk është namaz.

Argument kur'anor për dhënien e zekatit kemi ajetin: “**Dhe faleni namazin dhe jepeni zekatin...**” (El-Bekare : 43).

Argument nga suneti për zekatin është hadithi: “**Është ngritur islami mbi pesë shtylla:..., dhënia e zekatit...**”

Domethënia e sadakasë nuk kufizohet vetëm tek dhënia e lëmoshës me mjete materiale por ka kuptim më të gjerë sepse *çdo punë (vepër) e mirë konsiderohet sadaka*.

Sadakaja ka kuptimin e lëmoshës dhe të bamirësisë. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Thuaju robërve të Mi ta falin namazin dhe të japin nga ajo që Ne i kemi furnizuar, fshehtas dhe haptas, ...” (Ibrahim : 31)**

Specifika e zekatit është se prej pasurisë ndahet vetëm 2.5% (në disa artikuj 5%, në disa tjera 10% dhe në disa 20%) dhe nuk lejohet as më pak as më shumë se kjo, ashtu sikurse nuk pranohet që namazin e akshamit prej tri rekateve të falet dy rekate.

Në dallim prej zekatit, sadakaja mund të jepet edhe më pak e edhe më shumë se 2.5%, pra është e papërcaktuar.

Kategoritë e merituarra për marrjen e zekatit dhe sadakasë

Edhe sa i përket kategorive marrëse të zekatit dhe sadakasë ka dallime, kështu që ata të cilët e meritojnë zekatin e meritojnë edhe sadakanë, ndërsa ata të cilët e meritojnë sadakanë mund të mos e meritojnë zekatin. Sa i përket kategorive të zekatit Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Allahu caktoi që zekati t’iu takoj vetëm:

të varfërve,

të ngratëve,

punonjësve,

atyre që duhet përfituar (në islam),

e duhet dhënë për lirim nga robëria,

të mbyturve në borxhe,

dhe atij që ka mbetur në rrugën e Allahut...” (Et-Tevbe : 60)

Në këto kategori në të cilat është caktuar të jepet zekati jepet edhe sadakaja, por sadakaja jepet edhe në kategoritë e tjera përpos këtyre kategorive.

Ndodh shpesh që gjatë namazeve të xhumasë, hoxha të kërkoj prej xhematit ndihma për: raste të vërshimeve, tërmete, shërimin e të sëmurëve, jetimëve, nevojtarëve, ndërtimin e shtëpive të skamnorëve, ndërtimin e ndonjë shkolle, ndonjë spitali, furnizimi me ujë të pijshëm, etj.. Ndonjëherë në atë tubim të mjeteve ka kategori që duhet të japin zekatin, kështu që imami duhet ta informoj xhematin se ai i cili nuk e ka kryer dhënien e zekatit të jep pjesën e zekatit në rend të parë, kështu që ndonjë xhematli i cili i jep f.v. 50 ose 100 euro ai duhet të shkon në shtëpi dhe prej shumës të cilën e ka pas të përcaktuar 2.5% të atij viti të zbres dhe vetëm atëherë kur të arrin limitin e zekatit ai herëve tjera le të jep sadaka.

Ka xhematë që me dekada ka dhënë sadaka kurse njëkohësisht e ka pasur obligim zekatin dhe ajo shumë e ka kaluar limitin (nisabin) e zekatit të tij dhe asnjëherë nuk është informuar që të jep zekat dhe pastaj sadaka, kështu që ai nuk është liruar nga obligueshmëria e zekatit edhe pse ka dhënë sadaka edhe pse atë lëmoshë (ndihmë humanitare) e ka dhënë në kategori ku është e paraparë zekati.

Falja e bajramit nuk do të thotë se lirohesh nga mosfalja e namazit të sabahut. Dhënia e sadakasë nuk do të thotë se lirohesh nga dhënia e zekatit. Dhurimi i dhuratës dikujt nuk do të thotë se lirohesh nga borxhi të cilin ia ke atij.

Natyrisht se në rend të parë ai xhemat është dashtë pyetet para namazit të xhumasë se a e ka dhënë zekatin dhe nëse e kanë dhënë zekatin atëherë vetëm pas zekatit të jepet sadakaja në të cilën bën pjesë edhe donacioni, dhënia, dhurata, kontributi (vetkontributi) edhe ndihma vullnetare apo si do që të titullohet.

Një çështje tjetër... Në një prej kategorive marrëse të zekatit është edhe kategoria **“amilijne alejha”** (administratorët). Në fund të Ramazanit, imami edhe pse e merr pagën e paraparë për punën të cilën e kryen, e merr shpërblimin për shërbim të muajit të Ramazanit dhe cakton një xhematli për të mbledh zekatin (fitrin). Nga tubimi i zekatit (fitrit) në atë xhami ai i merr 5% të tubimit të zekatit (zekatul fitrit). Nëse i tubon 3000 euro i merr 150 euro, ndonëse për këtë nuk e informon xhematin.

Gjatë gjithë muajit të Ramazanit hoxha (hoxhallarët) ka thënë se zekati nuk jepet për ndërtimin e xhamive dhe të mirëmbajtjes së tyre apo për ndërtimin dhe për mirëmbajtjen e objekteve administrative të Këshillave të Bashkësive Islame, ndërsa 15% të shumës totale e ndajnë për paga dhe për këshillin.

Tubues të zekatit (administratorët) **“amilijne alejha”** nuk janë ata të cilët tubojnë mjete vetëm për një kategori (për veten e tyre), në këtë rast për medresenë, por **“amilijne alejha”** (administratorët) janë ata të cilët e tubojnë zekatin për të gjitha kategoritë e përmendura në Kur'an (në mënyrë të qartë). Profesorët e medreseve ua mësojnë nxënësve dhe u thonë mos pranoni se nuk ju takon juve zekati (fitri), ndërsa ata vet marrin paga prej tubimit të mjeteve të zekatit nëpër xhami ku ato shërbejnë gjatë muajit të Ramazanit.

Nëse institucioni i cili e tubon zekatin për të varfrit dhe për kategoritë e përcaktuara dhe një pjesë të tyre e ndan apo e ndal edhe për medresetë atëherë ky institucion mund të quhet **“amilijna alejha”** (administratorët) dhe ju takon zekati, por si të quhen **“amilijne aleja”** kur *ata janë ngrënës të zekatit dhe jo tubues të zekatit!*?

Është interesant të dëgjohen imamët në xhaminë në hyrje të së cilës shkruhet: **“Kjo xhami është ndërtuar nga arka e zekatit të Kuvajtit.”** Ata (imamët) thonë se: **Zekati nuk jepet për ndërtimin e xhamive.** Ndërsa pas namazit të xhumasë thonë: **Xhematë, sot do të tubojmë mjete për ndërtimin e xhamisë në “x” vendin apo në “x” fshatin.** Ata tubojnë mjete të sadakasë për xhami ndërsa në këtë rast të sadakasë (ndërtimi i xhamisë) lejohet të jepet edhe zekati.

“kurban bajrami” apo “iidi i kurbanit (iidul ed-ha)”

Në gjuhën arabe fjala “IIDË” do të thotë **kthim**, ndërsa në rastin konkret e ka kuptimin e **kthimit te Zoti**, apo me fjalë tjera e ka kuptimin e **pendimit**.

Kjo fjalë e gjuhës arabe është e përkthyer në gjuhën turke me fjalën “Bajram” dhe si e tillë është përdorë në popullin tonë. Pastaj gjeneratë pas gjeneratë ka vazhduar të përdoret edhe në të shkruar sa që ka mbet kjo si fjalë e vetme e cila përdoret për të zëvendësuar fjalën “IIDË”.

Në Kur'an fjala “IIDË” përmendet te rasti i Isait a.s. kur Havarijunët kërkuar prej tij që Zoti t'i zbres atij një sofër me ushqim. Thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Dhe (përkujto) kur Havarijunët thanë: O Isa, bir i Mejremes, a mund të na zbresë Zoti yt një Sofër me ushqime nga qielli? (Isai) Tha: Kini frikë Allahun nëse jeni besimtarë! (Ata) Thanë: Ne dëshirojmë të hamë nga ajo (sofër me ushqime) dhe të na binden (edhe më shumë) zemrat tona dhe të vërtetojmë bindshëm se na e the të vërtetën e të bëhemi dëshmues të saj! Isai, biri i Mejremes, tha: O Allah, Zoti ynë, zbritna nga qielli një sofër (me ushqime), të na jetë IIDË (festë-kthim te Ti) për paraardhësit tanë dhe pasardhësit tanë, të jetë argument prej Teje dhe dhurona se Ti je Furnizuesi më i mirë!” (El-Maide : 112-115)**

Përpos kësaj edhe në hadithin e Muhamedit a.s. në të cilin tregohet se kur ka shkuar në Medine i ka parë banorët e Medinës duke festuar dy ditë të caktuara dhe ka pyetur:

“Çfarë janë këto dy ditë?”

Ata u përgjigjën: Në periudhën e injorancës, këto ditë ishin festa për ne.

Pejgamberi a.s. tha: Allahu ua zëvendësoi me dy ditë më të mira, me IIDUL ED-HAN (kurban bajramin) dhe IIDUL FITR (fitër bajramit).”

Nga hadithi kuptohet se kemi dy bajrame (iide):

IIDUL ED-HA – festa e sakrifikimit të kafshës;

IIDUL FITRI – festa e dhënies së zekatul fitrit.

Në popull shumë herë është dëgjuar: Bajrami i madh dhe bajrami i vogël. Në esencë nuk ka bajram të madh dhe bajram të vogël, por ka: kurban bajram (iidul ed-ha) dhe fitër bajram (iidul fitr).

Në kuptimin e festës, në islam kemi të bëjmë me adhurim dhe jo vetëm me festim.

Termi kurban ka kuptimin e ofrimit që do të thotë sakrificë e cila të ofron te Zoti i Lartmadhëruar (bajrami i ofrimit të sakrificës). Termi kurban është përmend në ajetin Kur'anor ku Zoti i Lartmadhëruar i thotë Muhamedit a.s.: **“Lexoju atyre ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy ofruan ofrim sakrifice (karreba kurbanen) dhe njërit iu pranua e tjetrit nuk iu pranua. Ai (që nuk iu pranua) tha: Unë do të të mbys ty. E ai (që iu pranua) tha: Allahu pranon vetëm prej të singertëve.”** (El-Maide : 27)

Festa e bajramit manifestohet:

1. Duke e falur namazin e kurban bajramit; dhe
2. Duke bërë prerjen e kafshës shtëpiake, pra duke prerë Kurbanin.

Që të dyja këto veprime janë veprime adhurime ndaj Zotit të Lartmadhëruar. Kjo argumentohet me ajetin Kur'anor: **“Ti falu (fale namazin e kurban bajramit për hir të Zotit tënd) dhe prej kafshë shtëpiake (bëje kurban për hir të Zotit tënd).** (Keuther : 2)

Sa i përket namazit të kurban bajramit, falja e namazit është vaxhib dhe koha e faljes fillon me ngritjen e diellit nga horizonti sa një shtizë, derisa të arrijë në zenit dhe është vaxhib si për meshkujt ashtu edhe për femra gjë që nuk është traditë tek ne, ndërsa: **“Pejgamberi s.a.v.s. ka kërkuar që edhe gratë të dalin dhe të falin namazin e bajramit.”**

Menjëherë pas faljes së namazit të kurban bajramit fillon manifestimi tjetër me therjen e kafshës, pra ofrimit të kurbanit. Ka dallim në mes të prerjes së kurbanit dhe shpërndarjes së mishit të kurbanit. Prerja është vaxhib ndërsa shpërndarja e mishit është sunet. Mishin ndahet në tre pjesë: një pjesë (një e treta) jepet për të afërmit, shokët dhe fqinjët, një e treta i ndahet të varfërve dhe nevojtarëve. Një e treta ndahet për familjen.

As therja e kurbanit dhe as mishin nuk bëhet për të shkuar te Allahu, por kjo bëhet që ai mish të shpërndahet dhe të përfitojnë të gjithë, si nevojtarët e të varfrit, si fqinjët, qofshin besimtarë qofshin jobesimtarë. Këtë e dëshmon ajeti kur'anor ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Tek Allahu nuk arrin as mishin e as gjaku i tyre, por te Ai arrin bindja e juaj...”** (El-Haxh : 37)

Para ditës së kurban bajramit, ditë e cila quhet dita e therjes kemi edhe nëntë ditë tjera ku dita e nëntë është dita më e vlefshme e vitit. Zoti i Lartmadhëruar është përbetuar në dhjetë ditët e para të dhul hixhes, thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Betohem për muzgun e agimit dhe për dhjetë.”** (Fexhr : 1). Pra, dhjetë ditët e para të muajit dhul hixhe, janë ditë në të cilat është betuar vet Zoti i Lartësuar në Kur’an. Kurban bajrami forcon raportet njeri-Zot, nëpërmjet tekstit të cilin e thonë haxhilerët, e cila quhet telbije.

Lebejke Allahume lebejke – Të përgjigjem Allahu im, të përgjigjem,
lebejke la sherike leke lebejk – Të përgjigjem Ty që nuk ke shok, të përgjigjem,

inne’l hamde – Falënderimi është vetëm për Ty,

ve’n ni’mete – ndërsa mirësia është vetëm prej Teje,

leke ve’l mulk – Ty të takon sundimi,

la sherike leke lebbejk!! – Ti nuk ke shok, të përgjigjemi!

Gjatë ditëve të bajramit bëhen edhe Lavdërimet dhe Madhërimet ndaj Zotit me tekstin si në vijim:

Allahu ekber, Allahu ekber – Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi,

La ilaaha il-laAllahu Allahu ekber – Nuk ka Zot tjetër pos Allahut sepse Ai është më i Madhi,

ve lil-Laahil Hamd – dhe vetëm Atij i takojnë lavdërimet dhe falënderimet.

Agjërimi i ditës së bajramit është i ndaluar që do të thotë se kjo festë nuk manifestohet me agjërim siç festohet dita e arafatit, ditë për të cilën Muhamedi a.s. ka thënë: **“Agjërimi i ditës së Arafatit, i fshin gjynahet e vitit të kaluar dhe të ardhshëm.”**

Në ditën e arafatit me rastin e Haxhit Lamtumirës, Muhamedi a.s. në mes tjerash ka thënë:

“O njerëz! Dëgjojeni fjalën time, sepse unë nuk e di a to t’ju takoj më pas këtij viti, në këtë vend. Gjaku juaj është i shenjtë, pasuritë tuaja janë të shenjta dhe nderi juaj është i shenjtë, siç janë të shenjta në këtë ditë, në këtë muaj, në këtë vend.”

Në ditët e kurban bajramit ka zbritur edhe ajeti kur’anor: **“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe jam i kënaqur që për ju zgjodha islamin fe...”** (El-Maide : 3)

Burimin e urimit të kurban bajramit nuk e dimë, por po i përmendi disa prej tyre: përhajr bajrami; urime festa e bajramit; me fat bajramin; gëzuar festa e bajramit, përhajr kurban bajrami, me fat kurban bajramin, gëzuar festa e kurban bajramit.

Kemi dëgjuar edhe për urimin me tekstin me bereqolla bajramin dhe kthyerja e përshëndetjes alla alla razolla sene bereqolla. Që në përkthim do të kishte kuptimin: Me bereqet (begati) të Allahut Bajrami. Allahu qoftë i kënaqur edhe ty me bereqet (me begati) të Allahut qoftë (bajrami).

Fjala Bajram është marrë nga gjuha turke dhe jo nga gjuha arabe e cila është IIDË e që urimi do të kishte këtë kuptimin: **URIME IIDİ İ KURBANIT**, nëse është i papërcaktuar, urimi do të bëhej: **URIME IIDİ** (urime festë-kthimi dhe devotshmëria ndaj Allahut).

“xhami” apo “mesxhid”

Termi “xhami” dhe termi “mesxhid” janë dy fjalë diametralisht të kundërta që në kuptim etimologjik nuk kanë asgjë të përbashkët njëra me tjetrën edhe pse në përdorim njëra e zëvendëson tjetrën dhe anasjelltas.

Termi “xhami” është fjalë arabe e cila buron prej fjalës “xhemea” e që e ka kuptimin e *bashkimit*, *shumësit*, dhe *tubimit*, me fjalë tjera *vend tubimit*, pa marrë parasysh ai tubim a bëhet për namaz apo për diçka tjetër.

Termi “mesxhid” është fjalë arabe e cila buron prej fjalës “sexhde” (përrulje), d.m.th. vendi në të cilin bëhet sexhdeja.

Vendi ku bëhet namazi quhet “mesxhid” (edhe me xhemat edhe veçmas) sepse sexhdeja është prej pjesëve kryesore dhe më me vlerë në namaz. Edhe qëndrimi në këmbë (kijami) edhe rukuja janë pjesë kryesore të namazit, por sexhdeja e ka vlerën më të madhe për shkak të përrulshmërisë së skajshme në namaz. Për këtë arsye është zgjedhur ky term për këtë objekt.

Përdorimi i termit “xhami” dhe “mesxhid” në Kur’an dhe Hadith nuk e zëvendëson njëri-tjetrin. Këtë e ilustrojmë në vijim:

1. Fjala “mesxhid” e përdorur në Kur’an dhe nuk është përdorur fjala “xhami”.

Në Kur’an gjithmonë për fjalën “xhami” është përdorur termi “mesxhid”, por ne do t’i përmendim vetëm disa ajete:

“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej *Mesxhidi* Haramit gjer në *Mesxhidi* Aksa.” (El-Isra : 1);

“...dhe *mesxhidet* janë për Allah...” (El-Kehf)

“...vërtetë *mesxhidet* i ndërtojnë, i përmbajnë dhe përkujdesen ata të cilët besojnë në Zotin...” (En-Nisa)

“O bijtë e Ademit, vishuni bukur për çdo namaz (*mesxhid*).” (A’raf : 31)

Është interesant të përmendet që në Kur’an në gjuhën shqipe fjala “mesxhid” përkthehet me fjalën “xhami”, çka nuk do të ishte e drejtë.

2. Fjala “mesxhid” e përdorur në Hadith dhe nuk është përdorur fjala “xhami”.

Muhamedi a.s. në hadithe e ka përdorur fjalën “mesxhid”, e jo “xhami”, kur ka thënë:

“Udhëtoni me këmbëngulje për në tri *mesxhide*:

(e para) për në *mesxhidil* Haram,

(e dyta) për në *mesxhidi* (në Medine),

(e treta) për në *mesxhidil* Aksa.”

Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kur të hyjë ndokush prej jush në *mesxhid* le të thotë: O Zoti im mi hap dyert e mëshirës Tënde.”**

Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kur të hyj ndokush prej jush në *mesxhid*, le t’i falë dy rekate para se të ulet!”**

Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kush ndërton një *mesxhid*, duke kërkuar me të kënaqësinë e Allahut, Allahu do t’ia ndërtojë një të tillë në Xhenet.”**

Sikurse në përkthim të Kur’anit, ashtu edhe në përkthim të haditheve fjala “mesxhid” përkthehet xhami dhe prapë nuk do të kishte qenë e drejtë.

Gjenerata e parë nuk e përdornit termin “xhami” për “mesxhidin” por e përdornin vetëm fjalën “mesxhid”.

Me kalimin e kohës fillon të përdoret në togfjalësh “El mesxhid el xhami”, më vonë është anuluar pjesa e parë e togfjalëshit “el mesxhid” dhe ka mbetur vetëm fjala “xhami”.

Disa mendojnë se “xhamia” është objekti ku falet e xhumaja “el mesxhid el xhami” ndërsa “mesxhid” e mendojnë objektin ku falet vetëm namazi dhe jo namazi i xhumasë dhe ky mendim është gabim dhe një kategorizim i tillë është gabim.

Shumica gabojnë kur mendojnë se mesxhidi pa minare është “mesxhid” ndërsa mesxhidi me minare quhet “xhami”. Në kohën moderne kur ka filluar ndërtimi vertikal, pra, ndërtimi i objekteve shumëkatëshe nuk shihet interesimi për të pasur tërë katin e ndërtesës për “mesxhid” duke menduar edhe po të bëhej namazi në të, nuk do të ishte xhami sepse nuk ka minare, por do të ishte vetëm mesxhid dhe jo xhami.

Disa shkojnë edhe më larg sa që brendësinë e mesxhidit e quajnë xhami, ndërsa çka është oborr dhe jashtë xhamisë e quajnë mesxhid, ndërsa edhe kjo formë e ndarjes së xhamisë kështu është gabim.

Në të shkruar por edhe në popull përdoret fjala “sexhade” për shtrojen (qilimin) me përmasa të vogla e cila përdoret për falje të namazit edhe pse kjo sexhade vendoset mbi vendin e pastër si loti.

Disa nuk falen në qilim nëse nuk kanë sexhade edhe nëse shtroja e qilimit është më e pastër se vet sexhadja.

Nëse nuk ka sexhade dhe nuk ka qilim, lejohet të bëhet falja edhe në tokë (livadh, male, kodrinë, guri, e të ngjashme) sepse Muhamedi a.s. ka thënë: **“Më është bërë toka e pastër dhe mesxhid.”** Pra, hadithi e tregon se tërësia e tokës është mesxhid (vendfalje) në vete.

Përdorimi i sexhades është bërë në bazë të një hadithi të Muhamedit a.s. kur ka thënë: **“Ma përgatit sexhaden (humren) që të falem.”**

Muhamedi a.s. çështjen e parë që e bëri posa arriti në Kuba ishte ndërtimi i një mesxhidi për tu falur, ai mesxhid e ka luajtur rolin e qendrës politike, sociale dhe fetare.

Mesxhidi me kalimin e kohës përpos faljes së namazit është shfrytëzuar për të mësuar Kur’anin, për sqarimin e haditheve, për studimin e shkencave si shkenca e akaidit, pastaj shkenca e të drejtës islame, me një fjalë mesxhidi ka qenë shkollë fillore e mesme, medrese, fakultet.

Edhe pse me termin “xhami” kemi për qëllim vendtubimin e xhematit në mesxhid, mirëpo termi më adekuat është mesxhid se sa xhami edhe pse në mesxhid bëhet tubimi sepse tubimi bëhet për të falur namaz me xhemat por edhe për faljen e namazit të xhumasë por edhe nëse bëhet tubim për lexim Kur’ani, për shpjegim të haditheve, për të mësuar të drejtën islame për të përfutur këshilla islame, prapë se prapë termi bazë i saj është termi mesxhid, siç thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Dhe mesxhidet janë vetëm për Allah dhe në të mos iu lutni askujt tjetër pos Allahut.”** (El-Kehf)

“mulla” apo...!?

Fjala “mulla” është term që prejardhjen e ka prej gjuhës arabe por që në gjuhën arabe nuk shqiptohet kështu. Prej 28 shkronjave të gjuhës arabe nuk ka shkronjë “LL”. I vetmi rast ku theksohet shkronja “LL” është me rastin e fjalës “All-llah”.

Gjuha arabe e ka shkronjën “L” dhe në shkencën e të lexuarit të Kur’anit (texhvidit) me rastin e shtrëngimit apo forcimit të shkronjës “L” kur është me “fetha” apo me “dame” prapë se prapë lexohet “L” e fortë dhe jo “LL”.

Në Kur’an përdoret fjala “mevla”. Edhe në hadithe përdoret fjala “mevla” e cila vjen prej fjalës “Velij”. Fjala “Velij” do të thotë dashamir, i autorizuar, kujdestar, mbrojtës, etj.

Nëse fjalës “Velij” i jepet parashtresa e së shquarës “el” tregon për emrin prej 99 emrave të bukur të Allahut.

Për dallim nga gjuha shqipe, gjuha boshnjake e ka shkronjën “Lj” dhe shkronjën “Li”, mirëpo në përdorimin e fjalës “mevla” është anuar në përdorim të shkronjës “Li” dhe është përdor fjala “mulla” (mella) dhe nuk është përdor shkronja “Lj” pra “Mevlja”. Shihet se nuk është përdor me shkronjën “Lj” “Mevlja” por është përdor me shkronjën “Li” “Mevlla” e më vonë prej “ev” është shndërruar në “u” dhe në vend se të thuhet “Mevlla” është thënë “Mulla”.

Termin “Mulla” dhe jo “Mevla” e përdorin edhe në disa vende të Azisë së mesme dhe të largët të Afrikës mirëpo ky term nuk është me “Li” të plotë “Mulla” por në mes të “Mulla” dhe “Mula”, pra as “Mulla” e plotë dhe as “Mula” e plotë.

Gjuha shqipe ka shkronjë “L” dhe shkronjën “Li” dhe nuk ka nevojë të përdoret fjala “Mulla” për hoxhën apo imamin. Gjatë leximit të Kur’anit f.v. në pjesën e ajetit Kur’anor: **“Niemel Mevla ve niemen Nesire.” (El Haxh : 78) (“Nuk ka Mbrojtës më të mirë dhe nuk ka Ndihmëtarë më të mirë.”)** asnjëherë në gjuhën shqipe nuk lexohet **“Niemel Mevlla”** edhe nëse kemi për qëllim fjalën “Mevla” e mos të flasim kur është për qëllim “Mevla”.

Duke pasur parasysh se ky term përdoret për institucionin fetar dhe se “Mulla” është titull i cili i jepet udhëheqësit fetar lokal apo imamit të xhamisë, parashtrohet pyetja se a është në rregull të përdoret kështu?. Kjo është një çështje që moti është dashtë të rregullohet por...!?

Për prijësin fetar islam përdoret edhe fjala “imam” që do të thotë udhëheqës. Po ashtu përdoret fjala “hoxhë” që do të thotë mësues, pastaj fjala “mual-lim” që do të thotë arsimtar dhe fjala “muder-rise” që do të thotë profesor. Në kohë të fundit për hoxhën apo imamin ka filluar të përdoret fjala “teolog” që do të kishte kuptimin e teologut qoftë islam qoftë të krishterë apo katolik apo të ndonjë feje tjetër.

“minare” apo “meëdhen”

Qabja e cila është shtëpia e parë për adhurim ndaj Allahut nuk ka pasur minare (meëdhen), e as xhamia e Muhamedit a.s. në Medine nuk ka pasur minare (meëdhen).

Dihet se pasi që është bërë namazi obligim, muslimanët janë tubuar dhe janë konsultuar se si ta bëjnë lajmërimin për namaz. Në atë tubim janë paraqitur disa propozime:

- disa propozuan t’i bihet borisë sikurse te krishterët;
- disa propozuan t’i fryhet bririt sikurse te jehuditë;
- propozimi i Umerit r.a. ishte që thirrja të bëhet prej zërit të njeriut me ç’rast u miratua edhe nga vetë i dërguari i Allahut.

Ezani është sunnet i rregullt (sunnet muekede), ndërsa për një lagje edhani (ezani) është sunnet kifaje.

Bilalli r.a. para ezanit të sabahut shkonte nëpër rrugicat e Medines dhe i thërriste muslimanët që të përgatiteshin për namaz.

Në kohën e Omerit r.a. është rritur dhe është zhvilluar qyteti i Muhamedit a.s. kështu që bujqit, tregtarët, nuk mund ta dinin kohën e hutbes së xhumasë për këtë arsye e shtoi edhe ezanin e dytë i cili ezan thirrej prej kodrinave më të afërta të Medines, ndërsa ezani i parë thirrej para hutbes së xhumasë, i cili ezan është i përmendur në Kur’an në suretul Xhumua: **“O ju që keni besuar kur të thërret ezani për në namazin e xhumasë shpejtoni për ta falur namazin e xhumasë dhe ndërprejeni shitblerjen”.** (Suretul Xhuma,1)

Me kalimin e kohës u zgjerua feja Islame dhe me zgjerimin e saj edhe vendbanimet Islame. Deri në atë kohë xhamitë nuk kanë pasur as kupola por kanë qenë të hapura dhe me shatërvanë (ballkone) në të katër anët ndërsa mesi i hapur ashtu siç është Qabja e bekuar.

Pasi hynë në islam dy perandoritë më të mëdha të asaj kohe siç ishte perandoria bizantine dhe persiane atëherë filloi interesimi i ndërtimit të xhamive me stil tjetër.

Kupolat e xhamive kryesisht janë të arkitekturës persiane që janë quajtur kube (gjysmëhark) dhe nuk janë quajtur kulme të xhamive.

Përpos kupolave është paraqitur edhe interesimi i ndërtimit të minareve (meëdheneve).

Parashtrohet pyetja: Çka është Minarja (Meëdheni)?

Në gjuhen arabe fjala “nur” do të thotë dritë, ndërsa “minare” vendi i cili ndriçon, pra vend drite.

Në gjuhën arabe fjala “edhan” do të thotë thirrje ndërsa “meëdhen” do të thotë vend thirrje. Përderisa thirrësi i edhanit (ezanit) quhet Muedhin (muezin).

Edhani është simbol i fesë ndërsa meëdheni apo minarja është vendthirrja.

Meëdheni ka zënë vend të rëndësishëm në arkitekturën islame e cila më vonë është ndriçuar dhe ky element e ka marrë titullin e Minares për shkak të ndriçimit të saj dhe jo për shkak të thirrjes në namaz prej saj.

Sikurse namazi që i ka shartet ashtu edhe ezani i ka shartet e tij të cilat janë:

1. Që teksti i ezanit të jetë i renditur *do të thotë mos me i thënë dy rreshta me pushu një kohë e pastaj me vazhdua.*

2. Që të thirret ezani pasi të fillojë koha (*nuk pranohet që të thirret para se të fillojë koha*).

3. Që të këndohet fillim e mbarim prej një personi do të thotë (*mos me i këndua pjesët e para një muezin, e me i vazhdua muezini tjetër*).

4. Që të jetë në gjuhën arabe. *Nëse prej xhematit asnjë person nuk e di ezanin në gjuhën arabe lejohet me e thirr në gjuhën e tyre të cilën e kuptojnë.*

Në asnjë prej sharteve nuk parashihet që të ndizet drita dhe të ndriçohet meëdheni, qoftë për namaz të akshamit, jaciesë dhe sabahut qoftë për tërë ditën.

Përpos sharteve ezani ka edhe sunetet e tij të cilat janë:

1. Që muezini të jetë me abdest;
 2. Që muezini të ketë zë të bukur;
 3. Që ezani të këndohet në këmbë e jo ulur (*nëse s'ka mundësi në këmbë lejohet ulur*);
 4. Gjatë këndimit të ezanit, muezini të qëndrojë në drejtim të kiles.
 - kur të këndohet “*Hajje ales-salah*” muezini kthehet pak në të djathtë.
 - kur të këndohet “*Hajje al-el felah*” muezini kthehet pak në të majtë).
- Me ndërtimin e meëdheneve atëherë muezini rrotullohej rreth medhenit në sherife me qëllim që të kumtohej lajmi në tërë vendbanimin.
5. Në ezanin e sabahut sunet është që të shtohen fjalët “*Essalatu hajrun minen-nevm*” që do të thotë “namazi është më i vlefshëm se gjumi”.
 6. vendosja e gishtave në vesh gjatë këndimit të edhanit.
 7. Që muezini të hipë në ndonjë vend të lartë.

Nga ky sunet është paraqitur interesimi i ngritjes së meëdheneve (pirgjeve) me qëllim që muedhini të ngrihet në një lartësi sa më të madhe që sa më larg të dëgjohet thirrja e tij.

Vendqëndrimi i muezinit në Meëdhen quhet sheref sepse vendi ku thirret ezani ka vlerë dhe rëndësi të veçantë sikurse edhe thirrësi (Muezini) ka rëndësi të veçantë sepse e bën ftesën për namaz.

Me zhvillimin teknologjik muezini nuk hipë në medhen por vendosen zëzmadhuesit në sherife me fjalë tjera aty ku e thërriste muezini ezanin.

Medhenet vendoseshin në anën e djathtë të mesxhidit me qëllim që të kuptohej drejtimi i kibles (Qabes).

Pozita e Meëdhenit në anën e djathtë i shërbente popullatës që ta gjenin drejtimin e Mekes nëse nuk ishin në xhami.

Qëllimi i ndriçimit të minareve nuk ishte vetëm për informimin për namaz por edhe për orientimin se aty është xhamia dhe pranë saj apo rreth saj gjendet edhe qendra tregtare dhe tregtarët, vizitorët, në atë lokacion mund ta gjejnë edhe kuzhinën për ushqim pa pagesë, hanin (bujtinën) për fjetje pa pagesë dhe hamamin (banjot) për pastrim pa pagesë.

Pirgjet kanë pas nevojë që të ndriçohen me qëllim që të kuptohet se në ato vende ka xhami dhe qendra tregtare kështu që në vend se të quheshin meëdhen ato pirgje janë quajtur minare të xhamive.

Shihet se meëdheni apo Minarja në të kaluarën ka pasur për qëllim informimin për xhaminë dhe qendrën tregtare. Për të qenë njoftimi sa më i suksesshëm ishte e nevojshme që të ishte pirgu dhe ndriçimi sa më i madh në mënyrë që të shihej sa më larg.

Forma e minareve të arabët zakonisht ndërtohej në formë katrore, kurse të persianët dhe të osmanlinjtë ndërtohej në formë të rrumbullakët.

Sot minarja konsiderohet simbol i xhamisë ndërsa nuk përmendet se meëdheni është simbol i xhamisë kur dihet se ezani është sunet i namazit, me fjalë tjera thirrje për faljen e namazit pesë herë në ditë.

Është interesant se edhe në të shkruar gjithmonë thuhet *hipi muedhini në minare* dhe nuk thuhet *hipi muedhini në meëdhen* dhe thuaja se asnjëherë nuk përdoret fjala meëdhen, me fjalë tjera përdoret fjala edhan, por nuk përdoret fjala meëdhen.

“ma bëni hallall” apo...

Edukatë e jetës së mirë është që nëse i bën diç të keqe tjetrit, qoftë fjalë apo vepër, duhet t’i kërkosh falje. Muslimani dëshiron që t’i rregulloj raportet me të tjerët. Nëse një njeri i bën keq tjetrit, duhet t’i kërkoj falje dhe t’i premtoj se nuk do ta përsërit atë gabim. Në këtë mënyrë eliminohen shkaqet e urrejtjes dhe mbizotëron paqja, qetësia dhe lumturia.

Me faljen e gabimeve, jo vetëm që sigurohet qetësia dhe lumturia, por njerëzit mund të përmirësojnë edhe shëndetin e tyre, sepse njerëzit që kanë urrejtje dhe kanë ankesa prej njerëzve nga ngjarjet e kaluara kanë tension të lartë të gjakut.

Për kërkim falje në Kur’an nuk është përdor fjala **hallall**, por është përdor fjala **afv**. Ka edhe forma të tjera të kërimit të faljes, por fjala **hallall** nuk është përdor në Kur’an për kërkim falje.

Fjalën **Afv** Zoti i Lartmadhëruar e ka përdorur në ajetin kur’anor: “**Ti falu atyre (ve afu anhum) dhe kërko ndjesë për ta.**” (Ali Imran : 159)

Pastaj në ajetin tjetër kur’anor, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: “**Edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve (afijne anin nas). Allahu i do bamirësit.**” (Ali Imran : 133, 134)

Muhamedi a.s. e ka bërë këtë lutje: “**Allahume inneke afuffun tuhibul afve feafu annij.**” (O Zoti im, Ti je falës, e do faljen, më fal!)

Fjala **hallall** përdoret atëherë kur dikujt i ke bërë ndonjë haram apo nuk e ke kryer ndonjë obligim (farz) dhe nevojitet kompensimi material apo ndëshkimi në të njëjtën masë.

Edhe pse e kundërta e farzit është harami dhe e kundërta e haramit është farzi, mes këtyre dy ligjeve është hallalli, që do të thotë që nëse nuk e ke kryer ndonjë farz, ke bërë mëkat të madh dhe nëse e ke krye një haram, ke bërë mëkat të madh, ndërsa nëse ke vepruar diçka hallall, atëherë je në neutralen e këtyre dyjave.

Në terminologjinë e fikhut kemi ligjet siç janë: farzi, vaxhibi, harami, mekruhi, mustehabi, dhe mubahi, pra në mesin e këtyre ligjeve nuk ekziston ligj apo term **hallall**, por termin hallall e zëvendëson termi *mubah*, pra termi mubah është sinonim i termit *hallall*.

Mubah do të thotë *e lejuar*. Pra, kur njeriu është i lirë që të zgjedhë, ta kryej apo mos ta kryej atë veprim.

Në gjuhën shqipe fjalën **hallall** e përdorim për tri çështje, e ato janë:

1. Hallall – për kërkim falje;
2. Hallall – si formë kërcënimi apo mallkimi;
3. Hallall - si term lavdërimi.

1. Fjala hallall – për kërkim falje

Kur ta përdor njeriu fjalinë “ma bëj hallall” e ka për qëllim të thotë: Më falni nëse kam bërë ndonjë **haram** ndaj jush. Përdërisa ju i thoni: Nuk keni bërë ndonjë haram ndaj meje (ose, keni bërë haram, por tani atë haram po e shndërroj në të lejuar, pra hallall).

Kjo do të thotë se nëse fjalia “**Ma bëj hallall**” përkthehet fjalëpërfjalshëm, do të thotë: **ma lejo të ndaluarën** që e kam bërë ndaj jush. Nëse thuhet: “**Ta ka bërë hallall**”, ka për qëllim, ta ka bërë të lejuar të ndaluarën.

Çdo herë kur kemi të bëjmë me **haramin**, kemi të bëjmë me mëkatet e mëdha, sepse **haram** është çka ndalohet rreptësisht me argument të qartë.

Mëkatet e mëdha janë mëkatet të cilat kanë të bëjnë me haramin. Në mëkatet e mëdha bëjnë pjesë: vrasja, prostitucioni, vjedhja, etj..

Fjala “**ma bëj hallall**” zakonisht përdoret kur:

- dy persona kalojnë një kohë së bashku apo ndonjëri qëndron te tjetri mysafir;

- kontraktuesit, pas kryerjes së punëve,p.sh., kur punëkryerësi i thotë klientit: **nuk ta bëj hallall, sepse nuk ma ke bërë pagesën e plotë**, apo klienti i thotë: **nuk ta bëj hallall, sepse nuk ma ke kryer punën si duhet**.

- personi i cili ka punuar në detyrë publike apo administrative në ndonjë mandat apo në një kohë të caktuar. Dhe thotë **ma bëni hallall!**

- në momentin e paravdekjes: **ma bëj hallall, dhe ta kam bërë hallall**, dhe

- pas vdekjes: **inshaAllah ta ka bërë hallall**.

Nga të gjitha rastet, fjala **hallall** në përgjithësi përdoret në mes të:

- Individit me individin; dhe
- Individit me publikun.

Nëse kemi të bëjmë me individ-individ, atëherë kemi të bëjmë me mëkat (dëm) material dhe mëkat (dëm) moral. Kur individi i thotë individit ma bëj hallall, duhet t'i tregoj për mëkatin, se a është dëm material, e nëse është dëmi material, atëherë kompensohet dëmi.

Nëse është mëkat moral, atëherë përcaktohet dhe vetëm pas përcaktimit të mëkatit, atëherë vendos individi dhe e falë.

Nëse individi i thotë individit **ma bëj hallall**, dhe nuk e tregon mëkatin e caktuar, atëherë individi tjetër ka të drejtë të kërkoj të dijë llojin e mëkatit dhe vetëm pas përcaktimit të mëkatit atëherë vendos individi dhe e falë.

Nëse kemi të bëjmë me rastin e individit me publikun, atëherë kemi të bëjmë me individin me individë në bashkësi të papërcaktuar (dhe mëkat material dhe moral si më parë, pra me rastin e individit me individin).

Nëse në mesin e publikut gjendet ndonjë person i caktuar, i cili ka bërë mëkat të caktuar, atëherë i tregon se cilit person çfarë mëkati (harami) i ka bërë dhe i kërkon falje.

Ai i cili punon në institucion publik, nëse thotë **ma bëni hallall**, me këtë dëshmon se u ka bërë haram atyre.

Personat e tillë do të duhej të thoshin: Më falni për tejkalimet, për mangësitë, për ndonjë anashkalim. Më falni nëse kam bërë ndonjë vepër të pahijshme, ju kërkoj falje, etj.. Pra, për të gjitha çështjet të cilat njeriu nuk ka kompetencë dhe nuk mund të jetë i përkryer dhe nuk është absolut, i pagabueshëm. Ndërsa nëse ka bërë ndonjë haram, ai duhet të përcaktoj haramin apo masën e haramit, të asaj detyre apo të asaj pune.

2. Termi “hallall” si formë mallkimi

E kemi cekur më herët se shumica mendojnë se *hallalli* është e kundërta e *haramit*, por e vërteta nuk është kështu, sepse e kundërta e *haramit* është *farzi*.

Kur nëna i thotë djalit: **Nuk ta bëj hallall qumështin e nënës.** Ky lloj mallkimi nuk është i lejuar. Gjithënia e nënës për fëmijën gjatë dy viteve të para të tij është obligim ndaj Zotit të Lartmadhëruar, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Nënat le t’i japin gjë fëmijëve të tyre për dy vite të plota.” (El-Bekare : 233)**

Mëkatin apo sjelljen e keqe të cilën e bën fëmija pasi që të rritet nuk ka të bëjë me vitet e para të tij, kështu që nëna nuk e ka këtë të drejtë të mallkimit në këtë formë.

Obligimi për gjidhënie nuk ka të bëjë ndaj fëmijës, por ka të bëjë ndaj Zotit të Lartmadhëruar.

Te rasti i mallkimit kemi të bëjmë me kryerjen e farzit ndaj dikujt e që më pastaj atë farz të cilin e kemi kryer ndaj jush, tani po e tërheq dhe nuk e lë që të jetë hallall, por që të kthehet në haram.

3. Termi “hallall” si formë urimi dhe lavdërimi

E kemi përmend edhe më herët se fjala **hallall** është shprehje arabe që ka kuptimin “i/e lejuar”. Mirëpo tek ne, termin **hallall** e përdorim edhe në formë të lavdërimit dhe urimit, atëherë kur një person kryen një punë të rëndësishme dhe thuaja se të pamundur, në këtë rast të tjerët i thonë: **“Hallall të qoftë!”**

Me fjalën **hallall të qoftë** kanë për qëllim të lumtë, por nëse e përkthejmë fjalëpërfjalshëm do të thotë **e lejuar të qoftë**.

Për raste kur ndonjë njeri vepron një punë të rëndësishme, të mrekullueshme, mirë është që të thuhet **“ma shaAllah”** (vetëm Allahu ka dashur që të kesh këtë cilësi të veçantë dhe të bësh këtë vepër të veçantë) sepse vështirë se mund ta arrijë këtë dikush tjetër.

Përpos shprehjes **ma shaAllah** për cilësitë e veçanta dhe veprat e veçanta duhet falënderuar Zotin me shprehjen **Elhamdulillah**.

“hoxha tha” apo...

Një djalosh, duke ecur rrugës dëgjoji nga një njeri duke thënë: Hoxha tha: **Mishi i derrit** është ndaluar për arsye se në shkretëtirë yndyra ka qenë e dëmshme, ndërsa sot, mishi i derrit nuk është i ndaluar.

Djaloshi mendoi se mos është ndonjë gabim apo mos e ka dëgjuar gabimisht, dhe u interesua që ta vërtetoj, por e vërtetoi se Hoxha e kishte thënë një gjë të tillë.

Pastaj duke qëndruar në një bar cafe dëgjon prapë se: Hoxha tha: **Alkooli** ka qenë i ndaluar për atë kohë, ndërsa sot nuk ka asgjë të keqe të pihet një birrë apo dy birra dhe nëse nuk dehesh.

Djaloshi i cili i dëgjoji këto, filloi të mendoj se mos i është ngatërruar mendja apo nuk është diçka në rregull me të, dhe nuk e mori seriozisht nga shkaku se ishte në bar cafe dhe fjalët e bar cafe-ve nuk merren seriozisht.

Një ditë shkon në kuvendin komunal dhe i duhej të priste një kohë, aty nga zyrtarët e kuvendit të komunës dëgjon: Hoxha tha: Edhe nëse **nuk falem** nuk prish punë, me rëndësi është që zemrën ta kem të mirë.

Ky djalë i devotshëm mendon me vete: Po si është e mundur që Hoxha ta thotë këtë, kur dihet se namazi është adhurimi i cili të pengon dhe të parandalon nga imoraliteti dhe nga punët e këqija.

Një ditë shkoi në bibliotekë të shkollës, kur aty prapë dëgjon: Hoxha tha: **Mbulesa** është për të prapambeturit, ani pse nënat tona kanë qenë me mbulesë ato kanë qenë të prapambetura.

Në mbrëmje duke e përcjellë TV-në e dëgjon një zyrtar të lartë duke thënë: Hoxha tha: **Lënda fetare** nuk ka çka të mësohet në shkolla publike sepse ajo mësohet në xhamia. Më tutje dëgjon se Hoxha tha: Se ne jemi shtet laik dhe shteti është i ndarë nga feja. Djaloshi e dëgjon në TV fjalinë “**Hoxha tha**”, mirëpo aty në TV nuk sheh asnjë hoxhë, por sheh vetëm funksionarë e reporterë. Habitet me veten e tij dhe para se të shkon për të fjetur, në mbrëmje shkon pranë gjyshit, ulet tek ai dhe dëshiron që t’ia sqaroj çështjen se, a është e vërtetë se Hoxha i kishte thënë ato fjalë të cilat i kishte dëgjuar?.

Gjyshi i thotë: Prindërit e mi dhe stërgjyshërit e tu me krenari e kanë mbajtur fenë e tyre, ata çdo gjë e kanë sakrifikuar për fenë islame. Vetëm për fjalën *islam* kanë qenë në gjendje të japin gjithçka në jetë dhe vetëm për

këtë fjalë kanë jetuar. Pasi që e kanë dashur shumë këtë fe, kur u ka lindur ndonjë fëmijë e kanë emëruar me emrin Muhamed, në bazë të të dërguarit të Allahut dhe të dashurit të Tij. Kur u djali i tyre me emrin Muhamed u rrit, filloi të pinte alkool.

Kur u ka lindur ndonjë vajzë, e kanë emëruar me emrin Hatixhe, Fatime apo Ajshe. Por kur është rritur ajo, jo vetëm që nuk e ka bartur mbulesën, por është tallur me mbulesën, duke thënë se *kjo i takon periudhës së prapambetur*.

Për shkak se feja islame i ka dhënë rëndësi të posaçme diturisë, ata kafshatën e fundit e kanë shpenzuar që djali i tyre të shkollohet, por pas diplomimit dhe pas emërimit të atij fëmije në pozita të larta arsimore, ai thotë se nuk lejohet që fëmija i tyre të mësoj në ato shkolla, as së paku bazat themelore të fesë, pra lëndën fetare në njësi mësimore.

Për shkak se drejtësia ka vlerë të lartë dhe për shkak të kësaj drejtësie kemi jetuar dhe vepruar sepse drejtësia e Zotit në tokë është vendosur për gjallesa, i kanë dërguar fëmijët nëpër nivele të larta të fakulteteve të drejtësisë. E sot, ai fëmijë drejtësinë e Allahut e konsideron padrejtësi, ndërsa ligjet tjera të cilat janë vendosur prej epsheve të njerëzve i quan drejtësi, dhe të drejtën islame e quan *ligj i prapambetur, ligj i kohëve të lashta*, dhe sipas tyre kjo drejtësi nuk ka vend në kohën moderne dhe në këtë kohë të ‘zhvillimit njerëzorë’.

Gjyshi vazhdon e thotë: Titulli hoxhë ka qenë titulli më me vlerë se titulli akademik i sotëm, për këtë arsye shumë familje e kanë marrë këtë mbiemër dhe janë të shumta ato familja të cilat e kanë këtë mbiemër. Sot ato familje të cilat e kanë mbiemrin Hoxha janë në vende e në poste larta dhe në detyra të ndryshme shtetërore, andaj shpesh mund të lexosh në gazeta dhe portale se: Hoxha tha: Lënda fetare nuk do nëmësohet nëpër shkolla publike.

Në një portal apo gazetë tjetër: Hoxha (mbiemri Hoxha) në një takim zyrtar ishte duke pirë alkool dhe në mes tjerash tha: Unë i takoj një familjeje muslimane dhe nuk e agjëroj ramazanin.

Në një rast tjetër: Hoxha (mbiemri Hoxha) tha se, ne do të gjykojmë sipas ligjeve të cilat janë në fuqi dhe do të jemi të pakompromis në zbatimin e këtij ligji, mirëpo nuk e ka pasur për qëllim zbatimin e ligjit dhe të planprogramit të Zotit.

Nipi u habit. Shkoi të bie në gjumë dhe mendoi në vete, a thua ka qenë ëndërr apo jo, dhe nëse nuk ka qenë ëndërr, të shpresoj që as në ëndërr të mos e përjetoj një gjë të tillë e mos të flasim për në jetën e përditshme.

Selami, merhabaja dhe muhabeti

Fjala “selam”

Njeriu është i dalluar me të folur, përpos kësaj njeriu është qenie shoqërore, dhe takimet në mes njerëzve fillojnë me përshëndetje. Formula e përshëndetjes në islam është **“selami”**, për këtë arsye muslimanët kur të përshëndeten në mes veti përshëndeten me **selam** ngase prej kësaj fjale buron edhe emërtimi i islamit dhe muslimanëve, me një fjalë fjala musliman buron prej fjalës **selam** sepse rrënja e kësaj fjale është **se-le-me**.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Kur të përshëndeteni me ndonjë përshëndetje ju kthejeni përshëndetjen edhe me më të mirë, ose kthejeni në të njëjtën mënyrë.” (En-Nisa : 86)**

Kur shkoi Muhamedi a.s. në Miëraxh iu bë obligim namazi. Në fund të namazit në uljen e fundit e cila është kusht kryesor i namazit këndohet **“Ettehijati”**. Kjo është një simbolikë e qëndrimit të Muhamedit a.s. para Allahut sepse natën kur Muhamedi a.s. e bëri Miëraxhin, atëherë kur Muhamedi a.s. ishte para Allahut Allahu e përshëndeti me: **“es-selamu alejke ejjuhen nebiju”** që do të thotë “Paqja, mëshira dhe bekimi qoftë mbi ju o i dërguari im!”. Muhamedi a.s. e ktheu selamin **“Esselamu alejna”** që do të thotë “Paqja dhe bekimi të jetë tek ne”.

Nga kjo ngjarje historike dhe nga kjo mrekulli e Muhamedit a.s. e cila konsiderohet mrekullia e dytë pas Kur’anit, sehabet filluan ta përshëndetin njëri-tjetrin me: **Es-selamu alejkum!** Që do të thotë: Paqja, mëshira dhe bereqeti i Zotit qoftë mbi ju! Dhe kthyerja e përshëndetjes: **Ve alejkumus-selamu ve berekatuhu!** Që do të thotë: Edhe me ju qofshin paqja, mëshira dhe bekimi i Zotit!

Edhe pse kjo formulë e përshëndetjes ka filluar të praktikohet tek sahabet menjëherë pas mrekullisë së miraxhit, selami është edhe përshëndetja e parë e cila i është bërë njeriut të parë të njerëzimit, pra Ademit a.s.. Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kur Allahu xh.sh. e krijoi Ademin a.s. tha: O Adem, shko dhe përshëndete atë grup melekësh që janë ulur dhe mbaje mend përshëndetjen që do ta kthejnë ata, sepse ajo është përshëndetje që do të vlejë edhe për ty edhe për pasardhësit tu. Ademi a.s. shkoi dhe i përshëndeti melekët me selam, kurse ata (melaqet) ia kthyen selamin.”**

Fjala “**selam**” është edhe një prej 99 emrave të bukur të Allahut.

Dhurata më e madhe që i është dhënë njeriut është fëmija dhe gëzimi më i madh është kur njeriut i lind fëmijë, por kur kjo ndodhë në moshë të shtyer atëherë është edhe më e rëndësishme dhe melekët kur shkuan te Ibrahim i për të ia përcjell lajmin e gëzuar për lindjen e Ishakut ata e përshëndetën me **selam** dhe Ibrahim i ua ktheu me **selam**.

Pasi që të mirëpritën banorët e xhenetit ata do të përshëndeten me **selam**, thotë Zoti i Lartmadhëruar: **Përshëndetja për ta në të (xhenet) është selam**” (Tehijetuhum fijha **selam**).

Selami na e shton dashurinë dhe vëllazërinë ndërmjet njëri-tjetrit. Muhamedi a.s. thotë:

**Nuk do të hyni në xhenet derisa të mos besoni,
nuk do të besoni derisa të mos duheni mes veti.**

A të ju tregoj një gjë, të cilën nëse e praktikoni do të duheni në mes veti?

Sahabët thanë:Po.

Pejgamberi a.s. tha: Përhapeni selamin.”

Fjala “merhaba”

Fjala “**merhaba**” ka kuptimin e mirëseardhjes, mirëqenies, mirëpritjes, qetësisë dhe rehatisë. Edhe kjo fjalë buron nga Kur’ani. Rrënja e kësaj fjale është fjala “rehabe”.

Në botën tjetër besimtarët do të mirëpritën, që do të thotë do të ketë **merhaba**, pra do të ketë urim të mirëseardhjes, ndërsa jobesimtarët nuk do të mirëpritën dhe për këtë arsye nuk do të ketë për ta merhaba, në botën tjetër u thuhet: “**La merhaben bitum**” që do të thotë “nuk ka mirëseardhje për ju”.

Tek ne është traditë që deri sa të jetë në këmbë musafiri jepet selami, ndërsa pasi të ulen e përshëndesin njëri-tjetrin me **merhaba**. Transmetohet nga Aisheja r.a. se Muhamedi a.s. bijës së vet Fatimes i ka thënë: “**Merhaba bija ime.**”

Duhet pasur kujdes që të mos përdoret fjala **meraba** në vend të fjalës **merhaba** sepse në të shumtën e rasteve kur të shqiptohet kjo fjalë hiqet shkronja “h” dhe e shqiptojnë “**meraba**”.

Fjala “muhabet”

Fjala “**muhabet**” mendohet se ka kuptimin e bisedimit, diskutimit, të folurit, por e vërteta është se fjala muhabet nuk e ka asnjërën prej këtyre kuptimeve. Rrënja e fjalës muhabet është fjala ha-be-be e që e ka kuptimin e i/e dashur.

Ashtu sikurse prej fjalës **selam** buron fjala musliman, prej fjalës **rehabe** buron fjala **merhaben**, ashtu edhe fjala **muhabet** buron prej fjalës **habebe**.

Është e vërtetë se nëse ndonjë proces i bisedimit i cili sjell kënaqësi, lumturi, qetësi, siguri, atëherë ai proces bën që dy bashkëbiseduesit të duan njëri-tjetrit, e dashuria e dy bashkëbiseduesve quhet **muhabet**.

Në gjuhën arabe bashkëbisedimit i thuhet “**mukaleme**”.

E kundërta e fjalës muhabet është fjala “**mugadebet**”. Shpesh ndodhë që diskutimi të ketë mospajtime të ashpra e ky lloj diskutimi quhet fjalosje, e fjalosja shpesh shpie në urrejtje, ndërsa urrejtja krijon ndarje, dhe prej urrejtjes fillojnë kundërshtime të cilat sjellin fatkeqësi, e ky lloj diskutimi quhet **mugadebet**.

Dhe në fund... ashtu sikurse është sunet selami në fillim të bisedës, ashtu edhe përfundon biseda me selam, që do të thotë vuloset me **selam**, ndërsa pas ndarjes dhe pas përfundimit të bisedës (jo fjalosjes), pasi që biseda ka qenë e singertë, e ngrohtë, e frytshme dhe që ka sjellë dashuri në zemër, me qëllim që edhe herëve tjera të jetë po e njëjta bisedë, atëherë thuhet: isha te “x” personi dhe kemi bërë **muhabet**, që do të thotë biseda na ka shtua dashurinë e përzemërt ndaj njëri-tjetrit. Pra, fjala **MUHABE-t** ka kuptimin: mbjellje dashurie nga biseda, sepse prej bisedës e cila sjell dashurinë, buron mëshira. Prej dashurisë buron bashkëpunimi, prej dashurisë buron ndërlidhmëria dhe prej dashurisë buron lumturia.

Lutje

O Zoti ynë!
Na falë gabimet,
na falë për mangësitë,
na falë për lajthitjet
dhe për harresat tona.

O Zoti ynë!
Na prano veprat e mira,
na fshijë punët e këqija,
largona nga mëkatet
dhe nga të këqijat.

O Zoti ynë!
Na udhëzo,
na përmirëso,
na bën të zhvillohemi
dhe të përparojmë.

Zoti ynë!
Ti je Mbrojtësi ynë – na mbro!
Ti je ndihmësi ynë – na ndihmo!

Zoti ynë!
Ne jemi të dobët – na forco!
Na ka kapluar rreziku – na mbro!
Jemi të mundur – na ndihmo me fitore!

Zoti ynë!
Ne dëshirojmë kënaqësinë Tënde,
nuk e dëshirojmë hidhërimin.
Bëhu i kënaqur me ne
dhe largoje zemërimin.

Zoti ynë!
Kërkojmë mbrojtje tek Ti – prej epshit tonë,
kërkojmë mbrojtje tek Ti – prej të këqijave tona,
kërkojmë mbrojtje tek Ti – prej mëkateve tona
dhe kërkojmë mbrojtje tek Ti – nga të këqijat e ngatërresave tona.

Zoti ynë!
Na bën që ta njohim të vërtetën si të vërtetë
dhe ta pasojmë atë.
Na bën që ta njohim të pavërtetën si të pavërtetë
dhe të largohemi prej saj.

O Zoti ynë!
Bëje që sytë tonë të shohin me nderë,
veshët tona të dëgjojnë me nderë,
gjuhët tona të flasin me nderë,
dhe këmbët tona të ecin me hapa të sigurt
dhe në rrugë të drejtë.

O Zoti ynë!
Ti je Sunduesi absolut!
Ti i ke nën sundim çdo gjë.
Vepron çka do
dhe çka dëshiron.
Ti i jep pushtet atij që do
dhe e zbret nga pushteti atë që do,
e ngritë atë që do
dhe e poshtëron atë që do.
Ti ke mundësi për çdo send.
Nëse besimin e kemi të dobët – na e forco,
nëse kemi humbur rrugën – na drejto,
nëse mëkate kemi shumë – mos na qorto,
nëse nuk dimë – na mëso,
nëse harrojmë – na kujto,
nëse jemi të hidhëruar – na pajto,
nëse jemi larguar – na afro,
nëse zemrat tona janë bërë gur – na butëso,
nëse sëmuremi – na shëro,
dhe kur të vdesim – na mëshiro.

O Zot! Pranoje këtë lutje!
Dërgoji përshëndetje të dashurit tonë Muhamedit a.s.,
familjes së tij,
shokëve të tij,
dhe atyre që i pasojnë ata deri në Ditën e gjykimit.

Kapitulli i dytë

EZANI

Ezani, si shkruhet dhe si thirret?

Ezan do të thotë: **“Thirrje për namaz”** apo **“Proklamim për fillimin e namazit”**.

Si dispozitë, **“Ezani”** është ligjësuar në vitin e parë të hixhretit.

Muslimanët janë tubuar dhe janë konsultuar se si ta bëjnë lajmërimin për namaz:

- disa kanë propozuar t’i bihet borisë sikur te krishterët,
- disa propozuar me i fry bririt si te jehuditë, ndërsa
- propozimi i **ezanit** të sotshëm ishte propozimi i Umerit r.a., me ç’rast u miratua edhe nga vet i dërguari i All-llahut.

Ezani është sunnet i rregullt (**sunnet muekede**), ndërsa për një lagje **sunnet kifaje**.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur’an thotë:

“O ju që keni besuar, kur të thërret ezani për në namazin e xhumasë shpejtoni për ta falur namazin e xhumasë dhe ndërpriteni shitblerjen.” (Suretul Xhumua, 9)

Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kur të fillojë koha e namazit, dikush prej juve le të thërras ezanin...”**

Në një hadithë tjetër, Muhamedi a.s. ka thënë: **“Muez-zini, në ditën e kijametit do të jetë më i gjati dhe më i larti.”**

Duke pasur parasysh se, ezanin (edhanin) dhe veprimet tjera përcjellëse gjatë namazit i bëjnë muez-zinët (muedh-dhinët) e shtresave të ndryshme, që do të thotë muez-zinë të niveleve të larta, muez-zinë të niveleve të mesme dhe fillestar, do të sjell disa këshilla për përmirësimin e disa çështjeve të cilat në shikim të parë janë të lehta ndërsa në esencë nuk janë të lehta.

Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kur të fillojë koha e namazit, le të thërras dikush prej juve ezanin...”**

Në një hadith tjetër Muhammedi a.s. ka thënë: **“Muez-zini në ditën e kijametit do të jetë më i gjati dhe më i larti.”**

Duke pasur parasysh se ezanin (edhanin) dhe veprimet tjera gjatë namazit, i bëjnë muez-zinët (muedh-dhinët) e shtresave të ndryshme, që do të thotë muez-zinë të nivele të larta, muez-zinë të niveleve të mesme dhe fillestarë, do të sjell disa këshilla për përmirësimin e disa çështjeve të cilat në shikim të pare janë të lehta, ndërsa në esencë nuk janë të lehta.

Në faqet në vijim po fillojmë me këshillat fisnike.

Fjala ALL-LLAH

Fillimi i ezanit fillon me fjalën **“All-llahu ekber”**.

Shkronja e parë e fjalës All-llah është shkronja” elif” nërsa elifi është me zanoren “e “ el-fetha.

Kur muezini e thotë fjalën “All-llaahu ekber”, nuk duhet ta këndo: **“Aallaahu ekber”** por **“All-llaahu ekber”**.

Për ta sqaruar këtë duhet të themi si në vijim:

Ka dallim në mes të fjalës **“All-llahu ekber”** dhe **AAll-llahu ekber”**. Në rastin e parë është shkurtimi e shkronjës “a” ndërsa në rastin e dytë zgjatimi i shkronjës “a”.

Në rastin e parë, me All-llahu ekber dëshmojmë se Allahu është më i madhi, ndërsa

te rasti i dytë me **“Aallahu ekber”** shprehim dyshim se a është Allahu është më i madhi?. E të shprehurit dyshim në madhësinë e All-llahut është pabesim, për këtë arsye është haram të thuhet: **“Aallahu ekber”**.

Ata të cilët janë të specializuar në këndim, ata kur ta theksojnë fjalën Allah, e theksojnë theksin në mes të shkronjës, pra nuk e theksojnë as E të plotë Ellahu ekber por as A të plotë Allahu ekber.

Fjala “EKBER”

Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kur të fillojë koha e namazit, le të thërras dikush prej juve ezanin...”**

Në një hadith tjetër Muhammedi a.s. ka thënë: **“Muez-zini në ditën e kijametit do të jetë më i gjati dhe më i larti.”**

Duke pasur parasysh se ezanin (edhanin) dhe veprimet tjera gjatë namazit, i bëjnë muez-zinët (muedh-dhinët) e shtresave të ndryshme, që do të thotë muez-zinë të nivele të larta, muez-zinë të niveleve të mesme dhe fillestarë, do të sjell disa këshilla për përmirësimin e disa çështjeve të cilat në shikim të pare janë të lehta, ndërsa në esencë nuk janë të lehta.

Gabimet ndahen në:

1. **Gabime të rënda:** Gabimet të cilat janë gabime të patolerueshme (lehnul xhelij), që do të thotë gabim i qartë dhe i madh, dhe
2. **Gabime të lehta:** Mund të jenë gabime të tolerueshme (lehnul hafij), që do të thotë janë gabime që shumë pak hetohen dhe nuk e prishin kuptimin e leximit, por ndryshojnë vetëm konstruktin e leximit. Këtu bëjnë pjesë gabimet në përsosmërinë e rregullave. Këtë lloj të gabimit e kuptojnë vetëm të specializuarit. P.sh., moszgjatja plotësisht e zanoreve të gjata, apo mospraktikimi plotësisht i cilësive, por praktikim i pjesshëm i cilësive të shkronjave.

Në gabime të rënda bëjnë pjesë gabimet e patolerueshme (**lehnul xhelij**), që do të thotë gabim i qartë dhe i madh. E prej tyre janë si në vijim:

- Të prishurit e kuptimit,
- moszgjatja e zanoreve të gjata,
- mosleximi i qartë i shkronjave të qarta,
- mosbashkëngjitja kur duhet bërë bashkëngjitja,
- shkurtimi i Medi Lazimit,
- këndimi i shkronjës trashë kur është e hollë, ose këndimi i shkronjës hollë kur është e trashë,
- ndalja në vendet e ndaluara.

Një gabim prej gabimeve të rënda të patolerueshme (lehnul xhelij), është fjala “Allahu ekbeer” në vend të këndimit “**All-llaahu ekber**”. **Kështu pra Fjala “ekber” nuk këndohet “ekbeer”**

Në rastin e parë fjala “ekber” ka kuptimin “**më i madhi**” ndërsa

Në rastin e dytë fjala “**ekbeer**” ka kuptimin e një “**lloj tupani**”.

Jo vetëm në këtë rast, por gjithmonë zanorja e shkurtë është e ndaluar të këndohet gjatë.

Për këtë arsye duhet pasur kujdes që të mos zgjatet asnjëherë shkronja “e” me rastin e thënies “**ekber**” pra të mos thuhet “**Allahu ekbeer**”, por të thuhet “**All-llaahu ekber**”.

Fjala “EKBER” dhe jo “EGBER”

Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kur të fillojë koha e namazit, le të thërras dikush prej juve ezanin...”**

Në një hadith tjetër Muhammedi a.s. ka thënë: **“Muez-zini në ditën e kijametit do të jetë më i gjati dhe më i larti.”**

Duke pasur parasysh se ezanin (edhanin) dhe veprimet tjera gjatë namazit, i bëjnë muez-zinët (muedh-dhinët) e shtresave të ndryshme, që do të thotë muez-zinë të nivele të larta, muez-zinë të niveleve të mesme dhe fillestarë, do të sjell disa këshilla për përmirësimin e disa çështjeve të cilat në shikim të pare janë të lehta, ndërsa në esencë nuk janë të lehta.

E kemi treguar edhe më parë se gabimet ndahen në:

3. **Gabime të rënda:** Gabimet të cilat janë gabime të patolerueshme (lehnul xhelij), që do të thotë gabim i qartë dhe i madh, dhe
4. **Gabime të lehta:** Mund të jenë gabime të tolerueshme (lehnul hafij), që do të thotë janë gabime që shumë pak hetohen dhe nuk e prishin kuptimin e leximit, por ndryshojnë vetëm konstruktin e leximit. Këtu bëjnë pjesë gabimet në përsosmërinë e rregullave.

Në gabime të rënda bëjnë pjesë gabimet e patolerueshme (**lehnul xhelij**), që do të thotë gabim i qartë dhe i madh. E prej tyre janë si në vijim: Të prishurit e kuptimit.

Në gabim prej gabimeve të rënda bënë pjesë gabimet e patolerueshme (lehnul xhelij), është fjala **“Allahu egbeer”** në vend të këndimit **“All-llaahu ekber”**. Këtë çështje do ta sqarojmë si në vijim:

Në gjuhën arabe kemi fjalën “kebere” dhe fjalën “gabere”.

Fjala “kebere” e ka kuptimin *i madh*, ndërsa

Fjale “gabere” e ka kuptimin *i pluhurosor*.

Superlativi i këtyre dy fjalëve është “ekber” dhe “egber”.

“Ekber” do të thotë *më i madhi* ndërsa

“egber” ka kuptimin *më i pluhurosuri*.

Përfundim: me rastin e e ezanit dhe të ikametit duhet pasur kujdes dhe të thuhet “Allaahu ekber” (Allahu është më i madhi) dhe asnjëherë të mos shndërrohet shkronja “k” në “g” për shkak të afërsisë apo për shkak të moskujdesit apo për shkak të padijes.

Fjala “ESH-HEDU”

Muhamedi a.s. ka thënë: **“Kur të fillojë koha e namazit, le të thërras dikush prej juve ezanin...”**

Në një hadithë tjetër Muhammedi a.s. ka thënë: **“Muez-zini në ditën e kijametit do të jetë më i gjati dhe më i larti.”**

Duke pasur parasysh se ezanin (edhanin) dhe veprimet tjera gjatë namazit, i bëjnë muez-zinët (muedh-dhinët) e shtresave të ndryshme, që do të thotë muez-zinë të nivele të larta, muez-zinë të niveleve të mesme dhe fillestarë, do të sjell disa këshilla për përmirësimin e disa çështjeve të cilat në shikim të pare janë të lehta, ndërsa në esencë nuk janë të lehta.

Fjala “esh- hedu” nuk këndohet “eshedu”.

Fjala shehide ka kuptimin ka dëshmuar, ka deklaruar.

Ndërsa fjala esh-hedu ka kuptimin unë dëshmoj dhe deklaroj.

Në gjuhën arabe kemi tri shkronja “h”.

Shkronja “h” e rëndë,

shkronja “h” e mesme dhe

shkronja “h” e lehtë.

Shkronja “h” e lehtë është shkronjë e fjalës “Esh-hedu” dhe artikulohet prej fundit të fytit, është shkronjë fytore që do të thotë është shumë e lehtë.

Kur të thuhet fjala “esh-hedu” duhet të kalohet prej shkronjës “sh” të qiellzës dhe të kalohet thellë në fund të fytit dhe të artikulohet shkronja “h”.

Në fjalën esh-hedu nuk duhet të jenë të ngjitura shkronja “sh” dhe shkronja “h”, por duhet patjetër të bëhet një shkëputje e lehtë në mes të këtyre dy shkronjave.

Ne të shumtën e rasteve mund të dëgjojmë se kjo fjalë thuhet “Eshedu” duke e anuluar krejtësisht shkronjën “h”.

Përfundim : Thuhet “Esh-hedu” dhe nuk thuhet “eshedu”.

All-llahu ekber, All-llaahu ekber

Esh-hedu en laa ilaahe il-lall-llaah

Fjalët “EN LAA”

Lidhja e fjalës “En” me fjalën “Laa”

Fjala “**en laa**” nuk lexohet “**en laa**” por **el-laa**.

el-laa ilaahe il-l-All-llaah.ose

el-laaaa ilaahe il-l-All-llaaaaah

Sikurse gjuha shqipe edhe gjuhët tjera kanë rregullat gramatikore, e po ashtu edhe gjuha arabe ka rregullat gramatikore. Por përpos rregullave gramatikore, leximi i Kur’anit i ka rregullat e veta leximit dhe të këndimit, kurse në këtë rast jemi duke folur për ezanin i cili po ashtu ka rregullat e këndimit të ezanit.

Prej rregullave të këndimit është rregulli “IDGAM”.

IDGAM do të thotë bashkëngjitje.

Pastaj bashkëngjitja është dy llojesh.

1. Bashkëngjitje e Ç'HUNDËRZUAR (GOJORE), dhe

2. Bashkëngjitje e HUNDËRZUAR (HUNDORE).

Shkronjat e idgau bilaa guneh janë shkronja “L” dhe “R”, që do të thotë se: Nëse në fund të fjalës ndodhet nuni i pavoklaizuar (shkronja “N” me sukun) apo tenvini, ndërsa fjala në vijim fillon me njëerën prej shkronjave “L” dhe “R”, atëherë nuni i pavokalizuar (shkronja “N” me sukun) apo tenvini shkrihet dhe depërton në njëerën prej këtyre shkronjave, dhe bëhen një trup i përbashkët, i dyfishuar, por i pa hundorëzuar.

Përfundim: Në bazë të rregullit të lartpërmendur, në ezan nuk thuhet:

“Esh-hedu en laa ilaahe il-laLi-llaah”

por thuhet: **“Esh-hedu el-laa ilaahe il-laLi-Llaah”**

Vërejtje tjetër te ky tekst: Nuk duhet anashkaluar edhe Teshtidi te fjala “**il-l-All-Llaah**” që do të nënkuptonte: **Dëshmoj se nuk ka Zot pos Allahut**, ndërsa po të thuhet pa “teshtid” atëherë pjesa përjashtuese **il-laa** (përpos) do të merrte kuptimin e ndajfoljes “**te**”, që fatkeqësisht në disa raste disa prej muez-zinëve fillestarë nuk e këndojnë shkronjën “L” me teshtid.

Fjalja “ENNE MUHAMMEDEEN RESUULULL-LLAH”

Muhammedi a.s. ka thënë: **“Kur të fillojë koha e namazit, dikush prej juve le të thërras ezanin...”**

Në një hadith tjetër Muhammedi a.s. ka thënë: **“Muez-zini në ditën e kijametit do të jetë më i gjati dhe më i larti”**.

E kemi treguar disa herë se gabimet në lexim ndahen në:

1. **Gabime të rënda:** Gabimet të cilat janë gabime të patolerueshme (lehnul xhelij), që do të thotë gabim i qartë dhe i madh, dhe

2. **Gabime të lehta,** mund të jenë gabime të tolerueshme (lehnul hafij), që do të thotë janë gabime që shumë pak hetohen dhe nuk e prishin kuptimin e leximit, por ndryshojnë vetëm konstruktin e leximit. Këtu bëjnë pjesë gabimet në përsosmërinë e rregullave. Tash, të shikojmë pjesën e tekstit të ezanit **”Esh-hedu enne Muhammede-n- resuulull-llaah”**, edhe pse shkruhet kështu, këndohet **“Esh-hedu enne Muhammede-r- resuulull-Llaah”**.

Këtë çështje e sqarojmë si në vijim:

Sikurse te fjalët **“en”** dhe **“la”** ku bëhet bashkangjitja dhe shkrirja e shkronjës prej **“n”** në **“l”** ashtu e kemi edhe tenvinin prej theksit **“n”** në shkrirje dhe në bashkangjitje me shkronjën **“r”** sepse kemi të bëjmë me rregullin e cila quhet **“IDGAM”**.

IDGAM do të thotë bashkëngjitje.

E bashkëngjitja është dy llojesh:

Bashkëngjitje e Ç'HUNDËRZUAR (GOJORE) dhe

Bashkëngjitje e HUNDËRZUAR (HUNDORE).

Shkronjat e idgau bilaa guneh janë **“L”** dhe **“R”** që do të thotë se: Nëse në fund të fjalës ndodhet nuni i pavokalizuar (me sukun) apo tenvini, ndërsa fjala në vijim fillon me njërën prej shkronjave: **“l”** apo **“r”**, atëherë nuni i pavokalizuar (me sukun) apo tenvini shkrihet dhe depërton në njërën prej këtyre shkronjave, dhe bëhen një trup i përbashkët, i dyfishuar, por i pa hundorëzuar.

Përfundim:

Nuk thuhet: **Esh-hedu enne Muhammeden resulull-Llaah**

Por këndohet: **Esh-hedu enne Muhammede-r- resuulull-Llaah**

Fjalja “Hajje ales salaah” dhe fjalja “Hajje alel felaah”

Fjala salaah nuk shkruhet “salaah” por shkruhet “salaat”, mirëpo kur të këndohet dhe ndërpritet këndimi te shkronja “t”, atëherë shkronja “t” shndërrohet në “h” të lehtë.

E kemi përmend se në gjuhën arabe kemi tri shkronja “h”.

- Shkronja “h” e lehtë,
- Shkronja “h” e rëndë, dhe
- Shkronja “h” shumë e rëndë.

Fjala felah, në fund të saj e ka shkronjën “h” të rëndë rrënjësore të saj dhe kjo “h” ndryshon krejtësisht nga shkronja “h” e fjalës “salaah”.

Edhe pse këndimi bëhet nëpërmjet zëzmadhuesve por edhe pa zëzmadhues vështirë se mund të vërejmë te shumë muezzinë se e bëjnë dallimin e shkronjës “h” te fjala salaah prej shkronjës “h” te fjala “felaah”.

Përfundim:

Hajje ales- salaah - “h” e lehtë,

Hajje alel felaah - “h” e rëndë .

Për këtë arsye kur të bëhet Ikameti dhe ngjiten fjalët me fjalë tjera i këndojmë si në vijim:

hajje ales salaati, hajje ales salaah, dhe

hajje alel felahi, hajje alel felaah.

Ngjitja e fjalës “Allahu ekber” me “fjalën “Allahu ekber”

Teksti i parafundit i ezanit është përsëritja e fjalës **“All-llaahu ekber”** ku muez-zini e bashkëngjit fjalën **All-llaahu ekber** me fjalën **All-llaahu ekber**

Fjala **“All-llaahu ekber”** shkruhet **“All-llaahu ekberu”**, mirëpo rregull i këndimit është që të anashkalohet damme-ja, pra zanorja **“u”** dhe të bëhet ndalja me sukun pazanorë **“All-llaahu ekber”**.

Mirëpo, nëse vazhdohet këndimi, atëherë ajo zanore nuk anulohet, por këndohet **All-llahu ekberu**.

Shumica mendojnë se bëjnë gabim nëse e ngjisin fjalën **“All-llaahu ekberu-ll-llahu ekber”** dhe edhe kur ta ngjisin në përsëritjen e këtij teksti e këndojnë **“All-llaahu ekber Allaahu ekber”**, ndërsa të thuhet kështu është gabim në texhvid ndërsa e rregullt është që të thuhet: **“All-llaahu ekberu-LI-llaahu ekber”**.

Për ta sqaruar këtë themi:

Fjala **“Allah”** është fjala e cila ndonjëherë lexohet lehtë, e ndonjëherë lexohet rëndë.

Shkronja **“L”** e fjalës **“All-llaah”** lexo lehtë kur para kësaj fjale ndodhet **“kesreja”**. Shembuj: **Resuulil-laahi, Bil-laahi**. etj

Shkronja **“L”** e fjalës **“All-llaah”** lexohet rëndë kur para saj është fet’he-ja ose damme-ja.

Shembuj kur të jetë el fet-ha para fjalës All-llaah: **Minall-laahi Tall-laahi**

Shembuj kur të jetë ed-damme para fjalës Allah: **Resuul-u-LI-llaahi Jensur-u-LI-llaahu**

Njësoj është edhe te bashkëngjitja **“All-llaahu ekber-u-LI-llaahu ekber”** sepse damme qëndron para saj dhe nuk qëndron el fet-ha para saj.

Shartet (kushtet) e ezanit

Shartet (kushtet) e ezanit janë:

Ezani i ka shartet e veta, nëse një shart i mungon ai ezan është i pavlefshëm, e ato janë:

- Që teksti i ezanit të jetë i renditur, do të thotë, të mos thuhet dy rreshta, pastaj të pushohet një kohë e pastaj të vazhdohet me rreshtat në vijim.

- Që ezani të thirret pasi të fillojë koha, pra duhet të dihet që nuk lejohet që ezani të thirret para se të fillojë koha e namazit.

- Që në fillim e mbarim të këndohet prej një personi, që do të thotë, të mos i këndoj pjesët e para një muezin, e pastaj muezini tjetër të vazhdojë pjesën tjetër.

- Që të jetë në gjuhën arabe. Nëse prej xhematit asnjë person nuk e di ezanin në gjuhën arabe lejohet të thirret në gjuhën të cilën e kuptojnë.

Vërejtje: Nëse teksti i ezanit ndryshon në renditjen e thënieve p.sh. **“Haje alal felah” këndohet para “Haje ales-salah”, kjo është mekruh, që do të thotë muezini e rifillon thirrjen e ezanit, por nëse nuk e rifillon ai ezan pranohet.**

Sunnetet e ezanit

Sunnetet e ezanit janë:

- Që muezini të jetë me abdes.
 - Që muezini të ketë zë të bukur. Muhamedi a.s. e ka pëlqyer zërin e Mahdhurit dhe ia ka mësuar ezanin.
 - Që muezini të hipë në ndonjë vend të lartë (nëse ezani thirret pa ndonjë zëzmadhues).
 - Që ezani të këndohet në këmbë e jo ulur (nëse s'ka mundësi në këmbë lejohet ulur).
 - Gjatë ezanit muezini duhet të kthehet në drejtim të kiblës (*kur të këndohet “**Hajje ales-salah**” kthehet muezini pak në të djathtë. Kur të këndohet “**Hajje alel felah**” muezini kthehet pak në të majtë*).
 - Në ezanin e sabahut sunet është që të shtohen fjalët **“Essalatu hajrun minen-nevm. Essalatu hajrun minen-nevm”** që do të thotë “namazi është më i vlefshëm se gjumi”.
 - Gjatë këndimit të ezanit muezini të i vendos gishtat në veshët e tij.
- Pasi që i sqaruam kushtet dhe sunetet e ezanit tani do të sqarojmë se si shkruhet dhe si këndohet ezani.

Si shkruhet ezani?

All-llahu ekber-u, (ndërprerje) All-llahu ekber-u	الله اكبر الله اكبر
All-llahu ekber-u, (ndërprerje) All-llahu ekber-u	الله اكبر الله اكبر
Esh-hedu en laa ilaahe il-lall-llaah-u Esh-hedu en laa ilaahe il-lall-llaah-u	اشهد ان لا اله الا الله اشهد ان لا اله الا الله
Esh-hedu enne Muhammede-rr-resuulull-llaah Eshehedu enne Muhammede-rr-resulull-llaah	اشهد ان محمدا رسول الله اشهد ان محمدا رسول الله
Hajje ales-salaah hajje ales-salaah	حي على الصلاة حي على الصلاة
Hajje alel felah hajje alel felaah	حي على الفلاح حي على الفلاح
All-Llaahu ekber-u-Ll-llaahu ekber	الله اكبر الله اكبر
Laa Ilaahe il-la-ll-llaah	لا اله الا الله

IKAMETI

Mënyra e rregullt e ikametit

Ikameti është sunnet.

Për dallim nga ezani, ikameti thirret për t'u falë namazi, ndërsa ezani lajmëron për kohën e namazit.

Për dallim nga ezani, ikameti thuhet duke e ngjitur tekstin e njëjtë me të njëjtin pa ndërprerje, kështu që ndonjëherë dëgjojmë:

All-llaahu ekber All-llaahu ekber All-llaahu ekber All-llaahu ekber

E që do të duhej të thuhej:

All-llaahu ekber-u-Ll-llaahu ekber.

All-llahu ekber-u-Ll-llahu ekber.

Pastaj në disa raste dëgjohet:

Esh-hedu en laa Ilahe il-la-Ll-llahi Eshhedu en laa Ilaahe il-la-Ll-llahi

Esh-hedu enne Muhameden rresulullahi Esh-hedu enne Muhameden rresulullahi

Ose

Eshhedu en laa Ilahe il-lallahu eshhedu en laa Ilahe ilallah

Esh-hedu ene Muhammede-rr-rresulullahu Esh-hedu enne Muhamede-rr-rresulullahi

Edhe e para edhe e dyta janë gabim, pasi do të duhej të këndohej si në vijim:

Te rasti i parë:

Il-la-Ll-llaahu

Te rasti i dytë:

Resulull-Llaahi

Kështu pra, mënyra e rregullt është:
Eshhedu en laa Ilahe il-lallah**hu** eshhedu en laa Ilahe ilallah
Esh-hedu enne mummde-rr-rresuulull-llaah**hi** Esh-hedu enne muhamderr-
rresulull-llaah

Tekstin e ikametit në vazhdim ndonjëherë e dëgjojmë:
Hajje ales salaahi hajje ales-salah
Hajjje al-el felahi hajje al-el-felaah
Ose,
Hajje ales salaati hajje ale salaah
Hajje al-el felaati hajje al-el felaah
Edhe e para edhe e dyta janë gabim sepse përsëritja duhet të bëhet si në vijim:

Hajje ales-salaat**i** hajje ales-salaah
Hajje al-el felah**i** hajje al-el felaah
Në ikamet, për dallim nga ezani, i shtohet edhe teksti në vazhdim i cili përsëritet e që në të shumtën e rasteve e dëgjojmë kështu:

Kad kaametis salaati**i** Kad kameti salaati
E që me rregull do të duhej të thuhet:
Kad kaametis salaatu**tu** kad kametis salaah**h**
Dhe në fund ndonjëherë dëgjojmë:
All-llaahu ekber-u-ll-llaahu ekber
Laa Ilaahe ila-ll-llaah
Asnjëherë nuk duhet të thuhet “ila-ll-llaah” por gjithmonë duhet të thuhet “il-la-ll-llaah”.

Kështu pra teksti i plotë duhet të jetë si në vijim:
Laa Ilaahe il-la-ll-llaah.

Pasi që e sqaruam secilin tekst veç e veç, të shohim ikametin në tërësi:

All-llaahu ekber-u-ll-llaahu ekber. All-llaahu ekber-u-ll-llaahu ekber.	الله أكبر الله أكبر الله أكبر الله أكبر
Eshhedu en laa Ilahe il-lallaahu eshhedu en laa ilahe il-lallaah	أشهد أن لا إله إلا الله أشهد أن لا إله إلا الله
Esh-hedu enne Muhammede-rr-rresuulull-llaahi Eshehedu enne Muhammede-rr-rresulull-llaah	أشهد أن محمدًا رسول الله أشهد أن محمدًا رسول الله
Hajje ales-salaati hajje ales-salaah Hajje alel felahi hajje alel felaah	حي على الصلاة حي على الصلاة حي على الفلاح حي على الفلاح
Kad kaametis salaatu Kad kametis salaah	قد قامت الصلاة قد قامت الصلاة
All-Llaahu ekber-u-Ll-llaahu ekber Laa Ilaahe il-la-ll-llaah	الله أكبر الله أكبر لا إله إلا الله

Suretul-Fatiha

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿١﴾

Bismil-lahirr-rrahmaanirr-rrahiim(i)

الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿٢﴾

El hamdulil-lahi rabbil-aalemiin(e)

الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ ﴿٣﴾

Err-rrahmaanirr-rrahiim(i)

مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ ﴿٤﴾

Maaliki jevmiddiin(i)

إِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ ﴿٥﴾

Ijjaake neëbudu ve ijjaake nesteiin(u)

اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ﴿٦﴾

Ihdinaas-siraatal mustekiim(e)

صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ

وَلَا الضَّالِّينَ ﴿٧﴾

Siraatal-ledhiine enamte alejhim gajril-magduubi alejhim ve leddaaaal-
liin(e)

Sureja Fatiha dhe këndimi sa më i mirë i saj

Për shkak se këndimi i sures Fatiha në namaz është vaxhib dhe është sure e cila përsëritet në çdo rekat dhe është sure e cila këndohet edhe jashtë namazit dhe është bazë e çdo çështjeje dhe për shkak se këtë sure e këndojnë edhe fillestarët, e edhe ata të cilët kanë përvojë, të rinjtë, pleqtë dhe të natyrave të ndryshme, e shoh të arsyeshme të shkruaj për gabimet eventuale të cilat mund të ndodhin gjatë këndimit të kësaj sureje, dhe posaçërisht për ata të cilët këtë sure e kanë mësuar me të dëgjuar apo edhe me anë të shkronjave të gjuhës shqipe (transliterim), do t'i qasem vetëm disa fjalëve, në të cilat fjalë mund të gabohet ose që është gabuar në të kaluarën dhe duhet përmirësuar. Që në fillim, e theksoj se gabimet janë dy llojesh:

1. Gabime të rënda: Gabime të cilat janë të patolerueshme (**lehnul xhelij**), që do të thotë, gabim i qartë dhe i madh; dhe

2. Gabime të lehta: Mund të jenë gabime të tolerueshme (**lehnul hafij**).

Gabimet e lehta janë gabime të tolerueshme dhe janë gabime që shumë pak hetohen dhe nuk e prishin kuptimin e leximit, por ndryshojnë vetëm konstruktin e leximit.

Në gabimet e tolerueshme bëjnë pjesë gabimet në përsosmërinë e rregullave, të cilin e kuptojnë vetëm të specializuarit. P.sh: Moszgjatja plotësisht e zanoreve të gjata, apo mospraktikimi plotësisht i cilësive të shkronjave, por praktikim i pjesshëm i cilësive të shkronjave.

Nuk lejohet leximi me gabim të qartë. Ndërsa sa i përket gabimit të tolerueshëm (**Lehnul Hafij**), namazi është i pranueshëm.

Disa prej gabimeve do t'i përmendim në faqet në vijim.

Fjala “ISTIADHE”

EUUDHU

أَعُوذُ

“Istiadhe” quhet teksti “Euudhu bil-lahi minesh-shejtaanirr-raxhiim”.

Ajeti i ” Istiadhes” nuk është pjesë e suretul Fatiha, por është tekst i cila është sunet të këndohet para suretul Fatiha që pasqyrojnë kërkimin e ndihmës nga Allahu për mbrojtje nga djalli i mallkuar për të lexuara më drejt fjalën e Allahut,

Argument për këtë kemi ajetin Kur’anor, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe kur të lexosh Kur’anin, kërko mbrojtje tek Allahu prej shejtanit të mallkuar.” (En-Nahl, 98).

Ajeti është i përghithëshëm dhe thuhet cdoher kur të këndohet Kuran pasi që Kur’ani është Libër i Allahut dhe shejtani mundohet që lexuesit t’ia shtrembëroj fjalën e Allahut ndërsa leximi i Istiadhes nënkupton mbrojtje për leximin e drejtë të ajeteve të Kuranit.

Fjalën Euudhu (أَعُوذُ) duhet lexuar me shkronjën “Ajn”, pra me shkronjën “u” të rëndë sepse në gjuhën arabe kemi “u” të rëndë dhe “u” të lehtë e do të thotë: **Kërkoj nga Zoti që ta largoj nga unë Shejtanin e mallkuar.**

Euudhu (أَعُوذُ) me shkronjën “elif” pra me shkronjën “u” të lehtë do të thotë: **Kërkoj nga Zoti që të mi jep të mirat nga shejtani i mallkuar.**

1. Fjala “ELHAMDU LIL-LAAH”

ELHAMDU LIL-LAHI

الْحَمْدُ لِلَّهِ

Gabimi i parë i patolerueshëm (**lehnul xhelij**) është thënia “elhamdu-rilah” në vend të “elhamdu-lilah”.

Shumë prej xhematit kanë treguar se një kohë të gjatë nuk e kanë kënduar në namaz “ELHAMDU LIL-LAHI”, por “ELHAMDU RIL-LAHI”, pra në vend të “L” është kënduar me “R”.

Fjalën ”Elhamdu lil-Lah”, për shkak se është mësuar prej të dëgjuarit, ka shumë të cilët nuk e thonë “Elhamdu-Lil-laah” por “Elhamdu-Rilaah”.

Ky togfjalësh përbëhet prej dy fjalëve:

Fjalës “**hamede**” që do të thotë “ falenderim, dhe

fjalës “**Allah**” e cila për shkak të lidhjes shndërrohet në fjalën: “**Lil-laah**”.

2. Fjala “ERR-RAHMANË”

ERR-RAHMANI

الرَّحْمَنِ

Fjala “rrahman” buron prej fjalës “rrahime”.

Në gjuhën arabe kemi tri shkronja **h**.

Shkronja **h** e lehtë.

Shkronja **h** e rëndë.

Dhe shkronja **h** shumë e rëndë.

Te fjala “rrahime” kemi të bëjmë me shkronjën “**h**” të rëndë, për këtë arsye, kjo shkronjë duhet të theksohet rëndë në këtë fjalë, pra Rrah**h**man, e jo me shkronjën “h” të lehtë, pra Rrah**h**man, e as me shkronjën h shumë të rëndë “Rakhman”, e mos të flasim që të humbet në të tërësi shkronja “h” siç ndonjëherë ndodhë të thuhet prej ndokujt, bie fjala të lexohet “Rraman”.

3. Fjala “AALEMIINË”

AALEMIINË

عَالَمِينَ

Fjala “Aaleminë”, për shkak se është mësuar prej të dëgjuarit ka shumë të cilët e thonë “aleminë” me shkronjën “a” të “elifit” dhe nuk e thonë “aaleminë” me shkronjën “a” rënd të shkronjës “ajñ”.

Në gjuhën arabe kemi:

Shkronjën “a” e cila buron prej shkronjës “**ajñ**”, dhe

Shkronjën “a” e cila buron prej shkronjës “**elif**”.

Shkronja “a” te fjala “aalem” buron prej shkronjës “ajñ”, që do të thotë se është shkronjë e rëndë, pra kemi të bëjmë me “a” të rëndë dhe jo me “a” të lehtë.

4. Fjala “NEABUDU”

NEABUDU

نَعْبُدُ

Fjala neabudu pa e zgjatur shkronjën “u” është në rregull, por fatkeqësisht ne shpesh dëgjojmë se te fjala neabud shkronja “u” zgjatet dhe bëhet “neabuduu” e që është gabim.

Fjala abede do të thotë: adhurim.

Fjala eabudu do të thotë: adhuroj.

Fjala eabuduu do të thotë: I adhuroj ato (shumës).

Thënia e shkronjës “u” e shkurt tregon adhurimin në njëjës dhe jo në shumës, ndërsa nëse bëhet zgjatja e shkronjës “uu” (neabuduu) atëherë kalohet në adhurim në shumës, pra *i adhurojmë ata*. Për këtë arsye lexuesi në namaz por edhe jashtë namazit duhet pasur kujdes që të mos e zgjat shkronjën “u neabuduu), por duhet të ketë kujdes dhe ta këndoj shumë shkurt shkronjën “u”, pra “**neabudu**”.

5. Fjala “MUSTEKIIM”

MUSTEKIIM

مُسْتَقِيمٌ

Fjala **mustekiim** ka kuptimin e *rrugës së qëndrueshme, të drejtë dhe stabile*, ndërsa fjala “mustekin” do t’i jepte krejtësisht kuptim tjetër dhe do ta humbte këtë kuptim.

Edhe këtë fjalë, sikurse te rastet e mësipërme, për shkak të mësimi gojarisht apo prej të dëgjuarit dhe për shkak se shkronja “m” dhe shkronja “n” janë të përafërta, shumë prej xhematit nuk e kanë kënduar “MUSTEKIM”, por “MUSTEKIN”, pra në vend të shkronjës “M” është kënduar me “N”.

Përfundim: nuk thuhet: **Ihdines- siraatal mustekinë**

Por thuhet: **ihdines siraatal mustekimë**

Kjo është LAHN XHELIJ (gabim i patolerueshëm), dhe nëse është bërë me qëllim, namazi priset.

6. Fjala “EN’AMTE”

EN’AMTE

أَنْعَمْتَ

Fjala en’amte përbëhet prej dy fjalëve:

1. fjala “niëme”, dhe
2. fjala “te”.

Fjala “niëme” ka kuptimin: begati, të mira, bekim.

Ndërsa fjala “te” ka kuptimin e përemrit “TI”.

Shumësi i fjalës “niëme” është “en’am” dhe duhet të bëhet një shkëputje e domosdoshme, pra shkronja **n** këndohet qartazi me sukun, dhe kur të kalohet prej shkronjës “n” deri te shkronja “ajn” nuk duhet të dridhet shkronja “n” dhe nuk lejohet që shkronja “n” të bëhet sikurse të jetë me zanore ashru që të këndohet “anamte”, por duhet të këndohet “en’amte”.

Përfundim: Këndohet “siraatal ledhiine en’amte alejhim” dhe

nuk këndohet “siraatal ledhiine enamte alejhim”.

Këto janë vetëm disa prej këshillave dhe disa përmirësime të gabimeve të cilat mund të ndodhin gjatë këndimit të sures Fatiha, edhe pse mund të shkaktohen edhe gabime tjera të natyrave të ndryshme.

Mënyra e rregullt e fjalisë “Semiallahu limen hamideh”

Namazi, mund të falet me xhematë ose në mënyrë individuale. Kur të falet me xhematë, imami thotë “SemiAllahu limen hamideh(u)”, ndërsa xhemati thotë “Rabbenaa lekel-hamd”. Nëse falësi falet individualisht, atëherë thotë “SemiAllahu limen hamideh(u), Rabbenaa lekel hamd”.

Sqarimi në vijim u drejtohet atyre të cilët këtë fjali e kanë mësuar me të dëgjuar apo prej shkronjave shqipe (transliterim), kjo për arsye që të eliminohen gabimet eventuale. Që në fillim, duhet të them se gabimi me shumë gjasë mund të ndodh në këto dy raste:

1. Te fjala “**tesmië**” (semia);
2. Te fjala “**tahmidë**” (hamide-hu).

1. Te fjala “tesmië” (semia)

Fjala *semia* do të thotë *ka dëgjuar*.

Fjala *Allah*, është emri i bukur i Zotit.

Në gjuhën arabe kemi shkronjën elif dhe shkronjën ajn.

Te fjala *semia* dhe fjala *Allah* kemi dy shkronja *a*.

Shkronjën *a* në fund të fjalës *semia* dhe shkronjën *a* në fillim të fjalës *Allah*.

Shkronja *a* e fjalës *semia* është *ajni*, kurse shkronja *a* e fjalës *Allah* është *a* e elifit.

Fjalia “SemiaAllaahu” përbëhet prej dy fjalëve. Në këtë rast kemi lidhjen e fjalës *semia* me fjalën *Allah*, me ç’rast anulohet elifi.

Pra, në vend se të thuhet *semiaAllaahu*, thuhet *semiaLlahu*, pra mbetet ajni i fjalës *semia*, kurse eliminohet elifi i fjalës *Allah*, sikurse nuk thuhet *biAllahu*, por thuhet *bil-laahu*, ose nuk thuhet *resuluAllahu*, por thuhet *resulullahu*.

Përfundim: Te fjalia *semiaAllah*, elifi i fjalës *Allah* anulohet për shkak të ngjitjes së fjalëve, kështu që nuk thuhet *semiaAllahu* por thuhet *semiallahu* (ka dëgjuar *Allahu*, *semia*-ka dëgjuar).

Siç e përmenda më lart, këtë sqarim e bëj për shkak se shumica e fillestarëve mendojnë se gjatë eliminimit mbetet shkronja *a* e fjalës *Allah*, kurse e vërteta është e kundërta, pasi mbetet shkronja *a* (*ajni*) e fjalës *semia*.

2. Fjala “TEHMIDË”

Pas fjalisë *semiallaahu* pason teksti tjetër *limen hamideh(u)*, e ne do të ndalemi tek fjalia *hamide(hu)*, të cilën

- ndonjëherë e dëgjojmë *hamide*;
- ndonjëherë e dëgjomë *hamiden*.

E që të dyja janë gabim, pasi në të vërtetë në këtë rast kemi dy fjalë:

- e para, fjala *hamide*;
- e dyta, përemri lidhës *hu*, që ka kuptimin *atë*.

Përfundim: Fjala *hamide* plus *hu* ka kuptimin *atë i cili e ka falënderuar (Allahun)*. Vetëm se, sipas rregullit të texhvidit, zanorja *u*, për shkak të ndaljes nuk këndohet, dhe mbetet vetëm shkronja *h*, e cila prapë e ka kuptimin e përemrit lidhës. Kështu që, nuk është e rregullt as mënyra *limen hamiden* dhe as *limen hamide*, por e rregullt është *limen hamideh (u)*

***Lus Allahun xh.sh. që të
shpërblej donatorët me të
mirat e Tij, si në këtë botë, po
ashtu edhe në Botën tjetër.***

autori

Përmbajtja:

KAPITULLI I PARË	3
"TRASHËGIMI" APO "NDARJE"	4
MIRAZI, HARAM APO FARZ	8
VIZITA E VARREZAVE DHE LUTJA PËR PRINDËRIT NË DITËN E BAJRAMIT	12
<i>Vizita në varreza dhe lutja për të vdekurin dhe vetëm lutja për të vdekurin pa e vizituar te varri</i>	<i>13</i>
"BIBËL" APO "LIBËR"	17
HARAXHI, TAKSË APO	22
"ZEKAT" APO "SADAKA"	25
<i>Kategoritë e merituarra për marrjen e zekatit dhe sadakasë</i>	<i>27</i>
"KURBAN BAJRAMI" APO "IID I KURBANIT (IIDUL ED-HA)"	29
"XHAMI" APO "MESXHID"	33
"MULLA" APO...!?	36
"MINARE" APO "MEËDHEN"	38
"MA BËNI HALLALL" APO	42
"HOXHA THA" APO	46
SELAMI, MERHABAJA DHE MUHABETI	48
<i>Fjala "selam"</i>	<i>48</i>
<i>Fjala "merhaba"</i>	<i>49</i>
<i>Fjala "muhabet"</i>	<i>50</i>
LUTJE	51
 KAPITULLI I DYTË	 53
EZANI	56
<i>Ezani, si shkruhet dhe si thirret?</i>	<i>56</i>
<i>Fjala ALL-LLAH</i>	<i>58</i>
<i>Fjala "EKBER"</i>	<i>59</i>
<i>Fjala "EKBER" dhe jo "EGBER"</i>	<i>61</i>
<i>Fjala "ESH-HEDU"</i>	<i>62</i>
<i>Fjalët "EN LAA"</i>	<i>63</i>
<i>Fjalja "ENNE MUHAMMEDEN RESUULULL-LLAH"</i>	<i>64</i>
<i>Fjalja "Hajje ales salaah" dhe fjalja "Hajje alel felaah"</i>	<i>65</i>
<i>Ngjitja e fjalës "Allahu ekber" me "fjalën "Allahu ekber"</i>	<i>66</i>
<i>Shartet (kushtet) e ezanit</i>	<i>67</i>
<i>Sunnetet e ezanit</i>	<i>68</i>
<i>Si shkruhet ezani?</i>	<i>69</i>
IKAMETI	70
<i>Mënyra e rregullt e ikametit</i>	<i>70</i>

SURETUL-FATIHA	73
<i>Sureja Fatiha dhe këndimi sa më i mirë i saj</i>	74
<i>Fjala “ISTIADHE”</i>	75
1. <i>Fjala “ELHAMDU LIL-LAAH”</i>	76
2. <i>Fjala “ERR-RAHMANË”</i>	77
3. <i>Fjala “AALEMIINË”</i>	78
4. <i>Fjala “NEABUDU”</i>	79
5. <i>Fjala “MUSTEKIIM”</i>	80
6. <i>Fjala “EN’AMTE”</i>	81
MËNYRA E RREGULLT E FJALISË “SEMIALLAHU LIMEN HAMIDEH”	82